Prof. as.dr. ERIS RUSI

DR. AGIM KARAJ
HIPOKRATI I KOHËS SONË

biografi e autorizuar

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2026

Botuese: Irena Toçi

Redaktore letrare: Anjeza Hoda
Përkujdesja grafike: Adriana Matraku
Kopertina: Rogen Alushani
Foto në kopertinën ballore: Studio Rreli - Tiranë

ISBN 9789928961051

© Hëna Karaj

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA
Rr. “M. Gjollesha”, nr. 71, Tiranë 1023
ose K. Postare 1420
Tel.: +355 67 70 70 884
botimet.toena@gmail.com
toena.porosionline@gmail.com
https://toena.al

“Kirurgu i mirë duhet të ketë sy shqiponje,
zemër luani dhe dorë zonje!”

Dr. Agim Karaj

PËR GIMIN,
ME DASHURI DHE MALL TË PASHUAR

Të shkruash për njeriun me të cilin ke ndarë pesëdhjetë vite të jetës është jashtëzakonisht e vështirë. Është e vështirë të përmbledhësh në pak rreshta një jetë të tërë, të mbushur me vështirësi, kujtime, gëzime, halle, sfida dhe sakrifica. Gjithçka e ndërtuam së bashku, nga zeroja, me punë, përkushtim dhe vizion.

Për shumë njerëz, Gimi ishte një kirurg onkolog i shquar, një profesionist i zotë dhe një mjek i përkushtuar, që e adhuronte profesionin e tij me gjithë shpirt. Për mua, ai ishte djali inteligjent, i zgjuar dhe punëtor, me të cilin zgjodha të ndërtoja familjen time dhe të rrisja dy djemtë tanë.

E kam parë nga afër dashurinë e tij për kirurgjinë, përkushtimin ndaj pacientëve dhe shqetësimin e vazhdueshëm për shëndetin e tyre. E kam parë tek studionte libra mjekësorë, përgatitej për operacionet, duke u thelluar në literaturën profesionale në anglisht, frëngjisht dhe italisht. Ishte një shembull frymëzimi për mjekët e rinj: i mësonte, i këshillonte dhe u përcillte dijen e përvojën e tij. Pavarësisht arritjeve të mëdha profesionale, ai mbeti gjithmonë një njeri i thjeshtë, dashamirës, me zemër të madhe dhe i afërt me njerëzit. Edhe në vitet e fundit, kur problemet shëndetësore kërkonin që të kujdesej më shumë për veten, ai nuk iu nda profesionit. Vazhdonte të operonte çdo ditë, deri vetëm tri javë përpara se të mbyllte sytë.

Në vitin 2008 ndërtoi Spitalin Amavita, një nga ëndrrat dhe veprat më të rëndësishme të jetës së tij. Për tetëmbëdhjetë vjet iu përkushtua drejtimit të

spitalit dhe veprimtarisë kirurgjikale aty, së bashku me djalin tonë, Elvisin. Të dy punonin me të njëjtin përkushtim, diskutonin gjithçka së bashku dhe ishin të pandarë, të lidhur nga besimi, respekti dhe dashuria për atë që kishin ndërtuar.

Pas largimit të Gimit nga jeta, Elvisi mori përsipër të vazhdonte drejtimin e spitalit dhe veprën e të atit. Por, më 30 korrik, fatkeqësisht, edhe ai u nda nga jeta. Kjo humbje e dytë e thelloi edhe më shumë dhimbjen e familjes sonë.

Sot, pas pesëdhjetë vitesh jetë të përbashkët, të ndarë me dy djemtë tanë dhe pesë nipër e mbesa, ndiej mirënjohje të thellë për jetën që ndërtuam së bashku, por edhe një mall të pafund për Gimin dhe Elvisin.

Ky libër botohet me rastin e dyvjetorit të largimit të Gimit nga jeta. Ai është një homazh i çmuar për jetën, veprën dhe përkushtimin e tij. U jam thellësisht mirënjohëse të gjithë atyre që kontribuuan në realizimin e tij. Kujtimet dhe vlerësimet e tyre do të ndihmojnë që figura e Gimit të mbetet e gjallë në kujtesën tonë dhe të të gjithë atyre që e njohën dhe e vlerësuan.

Për njerëzit, Gimi do të mbetet një mjek i shquar dhe një njeri i respektuar; për kirurgët e rinj dhe mjekësinë, një aset i vyer; ndërsa për mua, shoku i jetës, me të cilin ndava pesëdhjetë vite pune, ëndrrash dhe përpjekjesh, njeriu, mungesa e të cilit ndihet çdo ditë.

Me dashuri, krenari dhe mall të pashuar,

Hëna

PARATHËNIE

Çdo biografi lind nga nevoja për të kuptuar nëse jeta që bëhet publike për lexuesin mbart një domethënie që ka vlerë për shoqërinë. Duhet të ekzistojë bindja e plotë që kontributet e një ekzistence të tërë, nuk mbarojnë kur njeriu ndahet nga kjo botë, por vazhdojnë të marrin kuptim sa herë që dikush tjetër i çmon dhe përfton vlera që i rezistojnë kohës. Biografia letrare vendos në qendër njeriun dhe profesionistin, pa lënë mënjanë pjesët e pathëna, të nënkuptuara, që mbushin ekzistencën e njeriut. Nëse do të mungonin paralelet e krahasimit mes jetës së protagonistit në qendër të rrëfimit dhe botës ku jetojmë, teksti i shkruar do të ishte vetëm një ushtrim i trurit, një kronologji bardhezi që do të kënaqte historianin, por do ta linte të pangopur lexuesin.

Libri "Dr. Agim Karaj: Hipokrati i kohës sonë", ka në qendër mjekun onkolog Agim Karaj, ish-drejtues i pavijonit të onkologjisë në Spitalin Universitar "Nënë Tereza", themelues i spitalit privat "Amavita" për kurimin e specializuar të sëmundjeve onkologjike, kirurgun e vlerësuar nga mijëra pacientë e familjarë, të cilët u kuruan nën kujdesin profesional të tij. Profili njerëzor i doktor Karajt ishte krejt ndryshe nga ai që mund të përfytyrohet mbi jetën e një mjeku me emër. Ai jetoi si një njeri i thjeshtë, i drejtpërdrejtë, që mishëronte karizmën e profesionistit, por pa krijuar largësi me njerëzit e zakonshëm.

Shumë prej kolegëve të tij e kanë kujtuar si një njeri që, shpeshherë, arrinte ta parandiente drejtimin e sëmundjes përpara se ajo të shfaqej

plotësisht me egërsinë e saj. Kjo cilësi, e dallonte nga shumëkush, e përkonte me një formë të rrallë të dijes, që lind kur përvoja, inteligjenca dhe vëmendja ndaj njeriut bashkohen në një pikë të vetme.

Mjekësia është shkencë, por kirurgu është në vijën e parë të frontit, ka përvojën e tij, sulmet, tërheqjen, disfatat dhe fitoret me sëmundjen më të rëndë të njerëzimit. E të zotërosh një dhunti të tillë, nënkupton të shohësh me shqisën e gjashtë ku është e orientuar sëmundja, t'i presësh hovin, të bësh pastrime të thella, ta vësh përpara deri në mposhtje përfundimtare.

* * *

Është një pyetje e qenësishme për jetën e gjithkujt, të cilën po e ndajmë me lexuesit e këtij libri: Çfarë mbetet prej nesh kur fryma bëhet ajër?

Në këtë botë kalimtare, doktor Karaj ka qenë një model frymëzues për kolegët dhe pacientët e tij, në çdo vend, personalitete të tilla meritojnë të kujtohen për meritat e tyre. Vetë kujtesa kolektive, ashtu si kujtesa e individit, nuk ecën sipas kronologjisë. Ajo hap dyer, rikthehet, lidh ngjarje që dikur dukeshin të shkëputura. Pikërisht këtë rrugë do të ndjekin edhe faqet që vijojnë: rrugën e njeriut që e fillon nga një fëmijëri e njëjtë për të gjithë, modeste e me pak kushte në Shqipërinë e viteve '60, që kultivon ëndrrën e profesionit, që ushqen mendjen me pasionin për gjuhët e huaja dhe lojën e shahut, që jepet me mish e me shpirt pas mjekësisë, ia del mbanë dhe manteli i bardhë bëhet një me jetën e tij përgjithmonë.

Kanë ekzistuar mjekë të shkëlqyer që dinin gjithçka për sëmundjen dhe shumë pak për njeriun. Ka pasur mjekë të tjerë që e fitonin besimin e pacientit me një fjali të vetme, por nuk e zotëronin po me atë siguri shkencën që kishin zgjedhur. Rrallëherë këto dy botë bashkohen në të njëjtin njeri, por doktor Agim Karaj ishte përjashtimi që përligjte rregullat. Intervistat me kolegët dhe miqtë e doktorit në këtë libër, do të dëshmojnë se ai nuk e pranonte kurrë sëmundjen si mal të pakapërcyeshëm. *Nuk ka sëmundje të pashërueshme*, shprehej doktor Karaj, e ky përkufizim, ishte një hap vendimtar në përballjen e parë të pacientit, kur mësonte betejën e ashpër që e priste përpara. Gjithçka në këtë botë është e lidhur me diçka tjetër dhe një masë tumorale nuk është vetëm një grusht qelizash që luftojnë

organizmin. Ku shkon ankthi i prindërve që marrin lajmin për fëmijën e tyre? Po ajo ndjesia e botës që shembet e gjitha mbi shpinën e njerëzve të zakonshëm, kur nuk ua priste mendja? E mendoni sa vdekjeprurëse do të ishte kjo goditje, po të mos shfaqej në horizont supi i mjekut që qëndron me ty, të këshillon, kujdeset, jep zemër, ndërhyn dhe e bën të natyrshëm këtë proces aq të dhimbshëm e dëshpërues për të sëmurin?

Shpesh doktor Karaj nuk e kishte për gjë të merrte rastet më të vështira, e me një vullnet të pathyeshëm, t'ia dilte mbanë që t'u kthente jetën atyre fateve të pashpresë, që kishin përjetuar derën e mbyllur në pafuqi nga mjekët e tjerë. Pikërisht mjekët, kolegët e doktorit ia njihnin këtë cilësi, ndërsa pacientët e perceptonin si dhunti që nuk mund ta gjeje kund tjetër. Mbase këtu qëndron edhe arsyeja pse u shkrua ky libër. Dr. Agim Karaj mishëron figurën e mjekut që e ushtroi profesionin si rrallëkush tjetër. E mbi të gjitha prirja për t'i dhënë botës sadopak nga shpirti dhe ekzistenca e përditshme, e dallon dhe e kthehen në një profil të spikatur, që meriton të kujtohet, të nderohet dhe të shërbejë si model për brezat që do të vijnë.

PROLOG

Nëntor 2024. Java e fundit e jetës

Në katin e dytë, aty ku janë dhomat e pacientëve, ndodhet edhe dhoma e doktor Agim Karajt. Nuk është një dhomë e veçantë. Nuk ka asgjë që ta dallosh nga të tjerat. Muret janë po aq të bardha sa në dhomat ngjitur. Dritarja hapet mbi të njëjtin oborr. Në korridor kalojnë të njëjtët infermierë, të njëjtat karroca me barna, të njëjtët hapa që ai i ka dëgjuar për vite me radhë. Vetëm se këtë herë, doktori nuk ecën nëpër korridor. Është shtrirë në shtrat.

Sëmundja ka bërë rrugën e saj. Nuk ka më vend për iluzione. Ai e di më mirë se kushdo tjetër se ku ka arritur. Gjithë jetën ka lexuar analiza, ka parë me qindra herë se si trupi i njeriut i dorëzohet ngadalë sëmundjes. Tani nuk ka nevojë të lexojë asnjë epikrizë. Mjafton të mbajë vesh, ta dëgjojë dhe ta kuptojë trupin e vet. Po mposhtet dalëngadalë. Doktori që ka shpëtuar mijëra jetë pacientësh, po e humbet përfundimisht betejën e tij. E kjo po i ndodh pikërisht këtij njeriu, që nuk ka dashur kurrë të flasë për vdekjen, që e acaronte të aludohej për vdekjen në praninë e tij.

Sa herë biseda afrohej deri aty, e ndryshonte rrjedhën e saj dhe e kalonte pa humbur kohë në një histori tjetër. Kishte gjithmonë një arsye për ta shtyrë atë bisedë, sikur vdekja, po të mos e përmendje me emër, do ta humbiste rrugën. Por njeriu, herët a vonë, përballet me orën e tij, me kohën që rrjedh e qetë, me durimin e saj shekullor si rëra në një klepsidër. Kokrrizë pas kokrrize.

Jashtë dhomës dëgjohen zëra. Doktori i dëgjon dhe kureshtar zgjat veshin të dëgjojë, kërkon të dijë, pyet çfarë bëhet përjashta, kush janë. Nuk i përgjigjet kush. Por ai e merr me mend dhe kjo e ngroh. Janë pacientë që duan pikërisht të konsultohen me të, ndaj një ndriçim i lehtë i përhapet në fytyrë.

Lajmëron ta ndihmojnë të ngrihet. Lëvizjet janë të ngadalta. Trupi nuk i bindet më si dikur, por krenaria nuk e lejon t'i presë njerëzit i shtrirë. Në korridor, ku janë vendosur kolltukët e pritjes, ai ulet me një lodhje që përpiqet ta fshehë dhe përballë tij ulen pacientët. Doktori merr analizat dhe i sheh me vëmendje. Nuk e jep veten që është në atë gjendje, përkundrazi i rreshton pyetjet sipas mënyrës së tij zhbiruese. Për disa minuta harron se edhe ai vetë është pacient. Kthehet përsëri aty ku ka qenë gjithë jetën. Përballë sëmundjes së të tjerëve. Si një gjeneral, në fushëbetejën e përhershme të tij!

* * *

Kujtesa nuk pyet për radhën e ngjarjeve. Ajo lëviz sipas një ligji të vet, të pashpjegueshëm. Mjafton një frymëmarrje më e rëndë dhe vitet fillojnë të rrëshqasin njëri pas tjetrit, si faqet e një libri që era i shfleton me shpejtësi. Hëna. Pastaj Endri e Elvisi. Më tej nëna e tij, babai, motra Lumturi dhe të dy vëllezërit që nuk jetojnë më. Më pas globi i botës, që rrotullohet ngadalë në hapësirën e paanë, ndërsa miliarda njerëz vazhdojnë jetën pa e ditur se sa e brishtë është ekzistenca. Diku larg, në cepin tjetër të hartës, shfaqet Kanadaja. Kontinenti i madh, i ftohtë, ku doktori provoi se njeriu mund ta rindërtojë jetën edhe kur mendon se gjithçka duhet të nisë nga e para. Shiriti ecën me shpejtësi marramendëse. Frymëmarrja rëndohet. Pastaj gjithçka ndalet.

Amavita.

Qendra e botës së doktor Agimit; vendi ku u mblodhën të gjitha rrugët e jetës së tij. Sikur çdo hap i hedhur deri atëherë, çdo largim, çdo kthim, çdo fitore dhe çdo humbje të kishte qenë vetëm përgatitja për këtë institucion. Mundohet të flasë, por ajri i del me zor nga mushkëritë. Kjo është sfida e çdo njeriu buzë misterit të madh. Hija e zezë përvidhet cepave të bardhë

të mureve, i ndërmend kutinë e shahut, lojën e parapëlqyer të tij. Sa do të donte të shihte diçka tjetër, që ta ngazëllente e t'i jepte forcë, por fuqitë janë të pakta. E ka kaluar gjithë jetën në ndjekje të triumfit mbi atë që ushtron pushtetin absolut në këtë botë: Vdekjen. Çdo kirurg e di se dera mes jetës dhe vdekjes nuk është një metaforë. Është një prag që të mban në vend ose të çon tjetërkund, në sallën e operacionit. Disa e kalojnë, të tjerë kthehen mbrapsht. Mjeku nuk bën gjë tjetër veçse lufton që ajo derë të mbetet edhe pak kohë e mbyllur. Ndoshta për këtë arsye nuk e tremb ideja e korridorit të fundit. Por do të kish dashur që ai korridor i bardhë, i gjatë, i ngushtë, për të cilin kanë folur aq shumë njerëz që kanë prekur kufirin mes jetës dhe vdekjes, të mos ishte aq i zhveshur, vetëm me mure të bardha dhe heshtje. Do të donte që mbi ato mure të vareshin posterat gjigandë të filmave që e kanë shoqëruar gjithë jetën. Të ecte mes tyre duke buzëqeshur, si një spektator që po del nga kinemaja pas një shfaqjeje të gjatë.

"*A Bronx Tale*"... Ky ishte filmi që nuk u lodh kurrë ta rishihte në ekran me Elvisin, që i bënte shoqëri dhe e shijonte historinë e djemve të Bronx-it, në Amerikën e largët. Ah, ajo kohë, dje, një jetë më parë, kur njerëzit nuk përkuleshin lehtë para fatit. Kishte diçka nga ajo botë që i ngjante edhe karakterit të tij në mënyrën si nuk e pranonte dorëzimin.

Pastaj korridori ndryshon. Nuk është më korridori i fundit, por bëhet korridori i krejt ekzistencës së tij. Dhe çdo derë që hap nuk të çon në një dhomë spitali. Të çon në një histori të jetës së doktorit.

* * *

Mjafton të përkulësh dorezën dhe do të gjendesh në një nga ditët më të rëndësishme të së kaluarës, që ka për protagonist doktor Agim Karajn. Pas njërës prej dyerve, është përvoja e jetuar në Kanada. Brenda asaj dhome që i ka të paprekura të gjitha ndjesitë e emigrimit, doktori e sheh veten të ri, mes një bote të panjohur, ku gjithçka duhej fituar nga e para. Sa larg duket tani ai kontinent, që dikur ishte aq pranë, sa çdo mëngjes zgjohej me mendimin se duhej të fitonte edhe një ditë tjetër në një vend të huaj.

Ai mendon që në një nga këto dyer, do të jetë rinia e tij, e zemra i rreh fort, kraharori i fryhet ngadalë, si deti që, para se të braktisë bregun, kthehet edhe një herë pas vetes, mbledh dallgët, lë një vijë të hollë shkume mbi rërë dhe humbet në horizont. Edhe kujtesa, ndoshta, i bindet këtij ligji. Nuk ecën sipas kalendarit, nuk respekton kronologjinë, nuk pyet se cila ngjarje ishte më e rëndësishmja. Ajo hap vetë dyert që dëshiron dhe kapërcen vite të tëra, ndalet te një fytyrë, te një zë, te një dorë ende e ngrohtë në shtrëngim. Korridori i Amavita-s nuk të çon më nga një pavijon në tjetrin. Të çon nga një epokë e jetës së doktorit në tjetrën. Dr. Karaj, pacienti dhe themeluesi i Amavita-s ecën ngadalë. Nuk ka më nxitimin e kirurgut që vrapon drejt sallës së operacionit. Për herë të parë, nuk e ndjek askush, nuk ka njerëz që thërrasin emrin e tij. Ka mbetur vetëm me kujtesën e jetës së vet. Përkul dorezën e derës së parë dhe ja ku shfaqet një fytyrë e qeshur... Në dhomë është djali i madh, fryma e frymës, Elvisi i tij.

KUR FRYMA BËHET AJËR

- me Elvis Karaj -

Zëri i njeriut është një nga gjurmët e papërsëritshme të ekzistencës së tij në këtë jetë. Një rrymë e lehtë ajri nis udhëtimin nga mushkëritë, vihet në lëvizje nga sinjale të padukshme të trurit, mbart mendime, ndjesi, emocione dhe, pasi përshkon fytin e merr formë nga lëvizja e buzëve, del në botë si fjalë.

Fjalët, fjalët, fjalë...

Njeriu është ajo esencë e padukshme që mbetet brenda zërit dhe që, sapo e dëgjon, të rikthen një fytyrë, një emër, mimikën, lëvizjen e duarve, sikur për një çast kujtesa të fitojë fuqinë për ta kthyer kohën mbrapsht. Ky libër e ka fillesën pikërisht nga zëri i regjistruar i Elvis Karajt, në takimin tonë të parë, kur morëm përsipër të nisnim së bashku një rrugëtim që në atë kohë na dukej i gjatë dhe i hapur përpara nesh. Së bashku planifikuam të mblidhnim njerëzit, dëshmitë, fotografitë, kujtimet dhe ato ngjarje nga jeta e doktor Agim Karajt, që të marra veçmas, mund të kenë nuanca të ndryshme, por që kur vendosen pranë njëra-tjetrës, fillojnë të ndërtojnë ekzistencën vitale të një njeriu.

Ideja ishte që jeta profesionale dhe profili njerëzor i doktor Karajt, të merrnin formë në një libër për të dëshmuar përpjekjet, peripecitë, betejat dhe arritjet e një karriere të gjatë në mjekësi, si dhe për të hyrë në botën familjare, në marrëdhëniet me miqtë e kolegët, në mënyrën si e jetonte profesionin. Sa interesante do të ishte po të depërtonim në mënyrën si doktori e pat ndërtuar besimin me pacientët, si i pat përballuar humbjet, si

i kish ushqyer pasionet e veta dhe si ia doli mbanë që, mes gjithë peshës që i kishte dhënë emri dhe profesioni, të mbetej një njeri i drejtpërdrejtë, i afërt dhe i vlerësuar për ata që kishin kaluar qoftë edhe pak kohë pranë tij.

Në bisedat e para me Elvisin ra në sy që burimet e informacionit dukeshin të shumta. Kishim përpara kolegë, miq, familjarë, ish-pacientë, njerëz që e kishin njohur në periudha krejt të ndryshme të jetës, dhe secili prej tyre mbante një Agim Karaj të vetin, një kujtim apo një histori që për të mund të kishte qenë e vogël, ndërsa për ne mund të shndërrohej në çelësin e një kapitulli të tërë.

Dilema e parë lidhej pikërisht me mënyrën si mund të vendoseshin dëshmitë njëra pranë tjetrës pa humbur ngrohtësinë e zërit që i sillte. A do mund të kalonte kujtesa nga biseda në faqe duke ruajtur dridhjen, ngurrimin, atë çast kur njeriu mbushet me frymë, mendohet çfarë të flasë dhe fytyra i ndryshon pa pasur nevojë të thotë asgjë? Ajo që kërkonim, ishte ritmi i një ekzistence, rruga e brendshme e një njeriu që ishte nisur nga rrethana të vështira dhe kishte ndërtuar, hap pas hapi, një jetë që do të lidhej përfundimisht me mjekësinë dhe me emrin e Amavita-s. Në atë kohë, nuk e dinim ende se vetë procesi i mbledhjes së kujtimeve do të bëhej pjesë e historisë së këtij libri dhe se zëri që po regjistroja për të dëshmuar mbi jetën e doktor Agim Karajt do të fitonte, me kalimin e kohës, një peshë krejt tjetër. Në takimet tona flisnim për njerëzit që duhej të intervistoheshin, për episodet që duheshin verifikuar, për fëmijërinë e doktorit dhe ato pjesë të jetës që Elvisi i kishte ruajtur në kujtesë me një saktësi të habitshme.

Atëherë gjithçka projektohej drejt së ardhmes. Do të takoheshim përsëri, do të regjistronim biseda të tjera, do të hapnim fotografi të vjetra, do të kërkonim njerëz që dinin histori të tjera, do të ndërtonim ngadalë librin, pa ngut, me bindjen e zakonshme njerëzore se kohë kishim përpara me bollëk, ndaj asgjë nuk na ngutte.

* * *

I rikthehem dëgjimit të intervistave me Elvis Karajn, e zëri që del nga altoparlantët e celularit ku është bërë regjistrimi, më rikthen në takimin

e parë në spitalin Amavita. Jemi ulur në një nga tavolinat e veçuara, gjithandej ka lëvizje, pacientë, familjarë që hyjnë e dalin. Elvisi flet, e në pamjen e tij nuk fshihet asnjëherë buzëqeshja nga fytyra. Zëri i tij i ngrohtë shkon me ngjyrën e kaltër të syve, sikur një det i paqtë të ketë përmbushur unin e tij, pas një mijë dallgësh e stuhish, që e kanë bërë më të mirë, më të aftë, më mirëkuptues me të tjerët dhe ndaj vetes.

- Unë isha krenar që isha djali i Agim Karajt, - kumbon zëri i Elvisit dhe mua më bëhet sikur nga kraharori i fuqishëm i këtij burri shtatlidhur, bashkë me mirësinë, përcillej edhe një siguri që të bënte të ndiheshe i mbrojtur nga çdo furtunë mbi kokë.

Libri për doktor Agim Karajn do të shkruhej mbi themelet e togfjalëshit "Duaje jetën", do të ngrihej si trungu i peme trupgjerë, e do të degëzohej në të gjitha historitë më domethënëse të jetës së doktorit, si gjethe të gjelbra të një peme që nuk njeh kurrë vjeshtë dhe dimër. Elvisi shkëputet një moment. Gjithë kohës, vëmendja e tij është në drejtim të hyrjes kryesore të spitalit, duket sikur kërkon të ketë në kontroll çdo situatë e pesha e punës reflektohet në qëndrimin e tij. Pastaj kthehet tek unë dhe vazhdon pikërisht aty ku e kishte lënë fjalinë. Flet shpengueshëm, por unë jam i përqendruar të lexoj lëvizjen e duarve, pulitjen e syve, regëtimat e trupit. Kujtesa e tij nuk ecën drejt. Sytë e kaltër lënë të kuptohet më shumë se zëri që përsërit sërish:

- Unë kam qenë krenar që isha djali i doktor Agimit.

- Gjithmonë kështu ka qenë? - e ngacmoj.

- Për babain kam qenë krenar gjithë jetën. Kjo nuk do të thotë se marrëdhënia jonë ka qenë e lehtë. Kemi pasur fërkime, përplasje, kemi kaluar edhe periudha kur nuk flisnim. Unë kam bërë të miat, ai kishte karakterin e vet. Ishte shumë i fortë, shumë i zgjuar, shumë nevrik. Kishte kërkesa të larta. Edhe vitet e fundit ndodhte që të grindeshim, por kjo kuptohet, ishim gjithë kohës bashkë, punonim bashkë, bënim planet me njëri-tjetrin. Por unë i hapja krahun përherë. Duhej ta kisha kuptuar më shpejt sa i veçantë ishte.

Fjalia e fundit mbetet pezull në ajër. Në marrëdhënien me prindërit ka një vonesë që e njohim pothuajse të gjithë. Kur jemi fëmijë, dimë shumë

pak për sakrificat që bëjnë për ne. Kur rritemi, nisim të kuptojmë dhe të vëmë gishtin mbi gjërat që nuk i kemi bërë si duhej dikur. E kur mosha nis të bjerë si borë e bardhë mbi flokët e tyre, e dimë që dashuria ka qenë pa kufi ndaj nesh. Kështu, mundohem të depërtoj më tepër në bisedë, dhe shtyhem pas në kohë:

- Nëse do të më jepje vetëm një pamje nga fëmijëria e doktor Agim Karajt, cila do të ishte?

Elvisi mendohet pak. Pastaj formon buzëqeshjen e përhershme në buzë dhe përgjigjet me një fjalë të vetme:

- Këpucët.

- Këpucët?

- Këpucët që ngjan sikur ta mbrojnë këmbën, me lëkurë nga sipër, por pa shollë nën këmbë. Ky është për mua simboli i fëmijërisë së babait. Nga sipër dukej sikur kishe këpucë, ndërsa poshtë këmba pothuajse prekte tokën.

Këpucët. Sa thjesht për të përshkruar një fëmijëri ku duhej të luftoje me të gjitha forcat, për të çarë në jetë. Nuk më duhen tani fotografitë e vjetra të Tiranës apo statistikat e nivelit ekonomik të familjeve tiranase në vitet '60. Mjafton vetëm përfytyrimi i shputës së një fëmije që prek tokën përmes një këpuce pa shollë, për të ndjerë gërvishtjen e lëkurës, dhimbjen, por edhe dëshirën e papërmbajtur për të çarë përpara.

- Profili i babait nis nga skamja, - vazhdon Elvisi. - Një familje me shumë halle, katër fëmijë. Kanë qenë në varfëri të skajshme. Babai i Gimit, gjyshi im, ishte berber. Njeri shumë i mirë, shumë i dashur, por kohë pas kohe kishte qejf të kthente ndonjë gotë. Në fundin e gotës, shumë njerëz mbyllin hallet e ditës, por gjyshi ishte i qetë, i urtë, i pazëshëm. Ndoshta defekti i vetëm i tij ishte që mezi ndihej prania e tij në shtëpi. Dhe ishte gjyshja ime, Xhavitja, ajo që mori frenat dhe vuri rregull në jetën e katër fëmijëve të saj.

Elvisi ndryshon ton sapo hyn në rrëfim figura e saj. Më ngjan se është një personazh i jashtëzakonshëm, që do të dalë edhe në rrëfimet e personazheve të tjerë të këtij libri. Nuk pyes më tej, sepse Elvisi vazhdon:

- Ajo ka qenë personazh; e fortë, burrneshë, grua shumë e zgjuar. Nuk kishte shkollë, por kishte një inteligjencë natyrore të jashtëzakonshme.

Kishte nuhatje, e kuptonte njeriun, e kuptonte sistemin, e dinte çfarë duhej thënë dhe kujt duhej t'ia thoshte.

Mundohem të përfytyroj profilin e këtyre dy prindërve, që kishin krijuar një vatër familjare që kërkonte kujdes, vëmendje e përkushtim. Por Elvisi menjëherë ka diçka për të thënë, ndaj vë veshin të dëgjoj:

- Im atë më ka treguar që në moshën dymbëdhjetë-trembëdhjetë vjeç, mamaja e dërgonte ndonjëherë të shkonte të kërkonte të atin, ta gjente e të ktheheshin bashkë në shtëpi. Ndoshta aty u poq, - vazhdon ai. - Vuajtja ka qenë e jashtëzakonshme. Kur një fëmijë kalon disa gjëra herët, rritet më shpejt. Gimi u poq herët.

- Po gjyshja e shprehte ndonjëherë që Agimi ishte ndryshe?

- Ajo e piketoi mes të tjerëve. Ma ka thënë vetë: "*Kisha katër fëmijët dhe pashë kush ishte më inteligjenti*". Ajo për të gjithë fëmijët kujdesej, por tek ai kishte një bindje tjetër. Në atë kohë shumë pak familje kishin ekonomi. Mishi ishte me racione, ushqimi ishte problem. Ato pak gjëra më të mira që gjente, ia ruante atij. Supën e peshkut ia bënte vetëm Gimit dhe thoshte me bindje: "*Ky do të na shpëtojë*." Gjyshja e ushqeu shumë me ambicie. I thoshte: "Ti je më i mirë, ti je yll, ti do të bëhesh dikush." E manifestonte çunin e vet. Doktori më i mirë në Shqipëri, kështu e shihte ajo. Është si te filmi "Aleksandri i Madh", ato skenat me nënën. Nëna ose të jep mjaltë, ose të jep helm. Gjyshja ishte e zgjuar, largpamëse dhe ajo tek Gimi investoi shumë.

- Çfarë di për origjinën e gjyshes? Nga vinte ajo?

- Nga një familje agallarësh. Gjyshja ime ka qenë gocë agai. Stërgjyshi im, Hajdar Deda, ka qenë një nga agallarët më të mëdhenj të Rrogozhinës, me shumë pasuri atje. E tregojnë të zgjuar, të aftë, serioz. Ai kërkon për nuse vajzën e agait të Pezës dhe martohet me vajzën e Ahmet bej Hoxhollit, që ishte një nga bejlerët e Pezës. Fisi Hoxholli më pas e ktheu mbiemrin në Peza, familje e Myslym Pezës. Nga ajo martesë lindën dy vajza. Njëra ishte gjyshja ime.

- Vetëbesimi i dr. Agimit, mendon se ishte i trashëguar prej saj?

- Po, unë besoj edhe te gjenet. Nuk është se Gimi doli nga rruga dhe u bë dikushi rastësisht. Stërnip beu, nip agai. Ka gjëra që janë në ADN-në

e individit. Pastaj erdhi sistemi dhe stërgjyshit i morën tokat, - vazhdon. - U bë argat në tokën e vet. Punonte për shtetin në pronën që dikur kishte qenë e tija. Por gjyshja kishte një aftësi të jashtëzakonshme për t'i dhënë rëndësi vetes. Nuk u dorëzua, sepse dinte të nxirrte në dritë si duhej edhe anën tjetër të medaljes. Shfrytëzonte edhe faktin se ishte e afërmja e Myslym Pezës, luftën partizane, lidhjet. Bënte mik drejtorin e policisë, shefin e policisë së zonës. Bënte martesa, lidhte fatin e njerëzve, që e bekonin më pas, pa mbarim. Ishte e tmerrshme...

- Më trego detaje që i ke të forta në kujtesë.

- Kam shumë. - Mendohet pak. - Kur shkoja në shtëpinë e saj, fotografia e Gimit ishte përballë në dhomë. Qante para fotografisë. Kur i vija unë vizitë, më veçonte. "Hapni rrugë, erdhi çuni i Gimit." Gimi kishte përparësi mbi çdo gjë. Nga ajo kam marrë lehtësinë për t'u lidhur me njerëzit... Marrëdhëniet me publikun. *Connections*. Ajo e kuptonte sistemin. Po të tregoj një histori tjetër, që ta kuptosh më mirë natyrën e gjyshes. Dilaver B. ka qenë drejtor policie, në vitin 1987. Gjyshja vendosi ta bënte mik. Shkon një ditë te puna e tij. Ushtari nuk e linte të kalonte. Ajo ngulte këmbë. Drejtori bëhet kurioz dhe thotë: "Lëreni të hyjë." Futet në zyrë dhe fjala e parë që i thotë është: "Po ti qenke i bukur, o të keqen nëna!" - Elvisi përplas pëllëmbën mbi tavolinë. - Magji! Mbaroi. E bëri mik. Pastaj i çonte gjëra të vogla, e merrte me të mirë. Kjo ishte natyra e gjyshes, ajo krijonte marrëdhënie. Dhe më tej, nëpërmjet atyre marrëdhënieve, ndihmonte njerëz. Ka futur njerëz në punë, u zgjidhte halle. Këtë e kam edhe unë. Nëse kam një njohje dhe mund ta përdor për t'i bërë mirë dikujt, e përdor. Me këtë parim kam ecur. E mira mbetet, përcillet. Mund të të dalë te djali, te vajza, nuk i dihet ku. E mira nuk harrohet.

- Kjo ishte filozofia e gjyshes?

- Kjo është filozofia e së mirës. Bota është e rrumbullakët. Nuk i dihet asnjëherë.

E shënoj në mendje. Në familjet tona trashëgojmë ngjyrën e syve, formën e fytyrës, ndonjë sëmundje. Në familjen Karaj trashëgohej edhe mënyra e lidhjes me njerëzit dhe filozofia e së mirës që ndahet me të tjerët.

- Nëse natyra e gjyshes do të kishte qenë tjetër, çfarë do të ishte bërë Agim Karaj?

Elvisi përgjigjet menjëherë: **-** Gimit i doli dega e inxhinierisë së pyjeve. Shkoi në shtëpi i gëzuar dhe i dha lajmin të ëmës, por ajo u nxi në fytyrë: "Çfarë, inxhinier pyjesh? Të shkosh mes maleve? Unë mezi të kam rritur, të dua afër." *Elvisi bën me dorë gjestin e dikujt që tërheq një fëmijë.* - E mori për dore dhe shkoi t'ia ndryshonte degën.

- Domethënë onkologjia shqiptare mund t'i ketë një borxh një nëne posesive?

Qesh me të madhe. - Po ta shohësh kështu, po. *Por historia nuk mbaron aty. Kur Agimi vendosi të shkonte në Kanada, në fillim të viteve nëntëdhjetë, e njëjta grua e përjetoi largimin si kërcënim.*

- Nuk donte që të largohej. Shkoi deri aty sa i shkroi një letër komitetit: "Mos e lini të ikë, se nuk kthehet më."

- Shkroi letër kundër djalit të saj?

- Aq larg shkoi. Ishte një dashuri e jashtëzakonshme, e frikshme ndonjëherë. E donte afër. Gjatë kohës kur Gimi ishte në Kanada i shkruante: "Kthehu. Ti tani më duhesh mua. Më ka marrë malli. Jam e sëmurë."

- I dinte tastet që duhej të shtypte brenda zemrës së tij?

- Patjetër, për dashurinë e fëmijës shkon edhe në ekstrem. Ndaj malli sikur i përshpejtoi ditët e saj mes njerëzve. Im atë nuk u kthye në kohë dhe gjyshja ndërroi jetë. Ai bëri çmos të vinte në varrim dhe kjo i mbeti peng në zemër, përherë.

Biem në heshtje të dy. Në korridor kalon dikush dhe për një çast zëri i tij mbulon mendimet që po bluanim përbrenda. Unë mundohem ta kapërcej atë pauzë, duke pyetur në drejtim tjetër:

- A ndikoi kjo në profesionin e doktorit kur u kthye në Shqipëri nga Kanadaja?

- Po, im atë tregonte një farë dobësie për nënat në moshë, për të varfrit, për hallexhinjtë. Mendoj se vinte nga fëmijëria, nga ajo që kishte vuajtur vetë. Janë gjurmë që mbeten e nuk fshihen kurrë...

Gjurmët e lëna nga këpucë pa shollë.

Në fund, gjithmonë kthehemi te këpucët...

* * *

Jeta e një njeriu nuk mund të kuptohet vetëm përmes punës. Dua të mësoj çfarë e ushqente mendërisht, cilat ishin pasionet që i jepnin frymëmarrje jashtë spitalit dhe çfarë bote kishte ndërtuar për veten përtej mjekësisë doktor Agim Karaj. Afrohem kah Elvisit dhe e pyes:

- Çfarë e tërhiqte dhe çfarë e bënte të ndihej vërtet mirë doktorin?

- Gimi ishte njeri kompleks, - përgjigjet Elvisi. - Intelektual i mirëfilltë. Kishte kapacitet dhe prirje, të cilat e shoqëruan gjithë jetën. I përthithte dhe i mësonte pa vështirësi gjuhët e huaja. Lexonte libra pa fund. Kishte qejf poezinë, këngët, muzikën. Ishte artdashës.

Fjala "kompleks" mbetet pezull për një çast. Elvisi ngjan se po ilustron një natyrë që dukej se kërkonte vazhdimisht ushqim të ri për mendjen.

- Muzika, për shembull, ishte nga pasionet e tij. Ferdinand Dedën e kishte kushëri. Im atë e donte muzikën dhe kjo sikur e përcillte në një dimension tjetër kur duhej. Por pasioni më i madh i tij ka qenë loja e shahut. Shahu kërkon durim, intuitë, aftësinë për të menduar disa hapa përpara dhe për të parë një pozicion para se të bësh lëvizjen e pakthyeshme pas.

- Shahu e ka ndihmuar të mendonte përpara, të parashikonte lëvizjet dhe të mos hynte në një situatë pa e parë deri në fund?

- Me ditë e net të tëra im atë i është kushtuar kësaj loje, ku duket sikur imitohet jeta në botën reale. Ai ka qenë një shahist shumë i mirë që në rininë e tij. Ka mundur edhe Fatos Muçën, kampionin e Shqipërisë. Megjithatë nuk mbetej vetëm te ushtrimet që aftësonin mendjen. Gimi ka pasur pasion edhe sportin, është marrë me boks një periudhë të caktuar të jetës. me pak fjalë, ka qenë i gjithanshëm.

Pastaj, sikur të donte ta shpërbënte çdo përpjekje për ta kornizuar të atin në strukturën e një portreti të rregullt të intelektualit klasik, Elvisi shton:

... - Ta dish që apasionohej edhe për historinë e gangsterëve që bënë histori në Amerikë. Seç kishte një tërheqje ndaj atyre njerëzve që e nisën nga hiçi dhe u ngjitën në majat e jetës ekonomike në kontinentin e ri. Gimi kishte tërheqje për personazhet e forta si John Gotti, Paul Castellano. Një

nga filmat e preferuar të tij ishte "*A Bronx Tale"* me Robert De Niron. Unë atë film e kam parë me babën dhjetë herë.

- Çfarë mendon se pëlqente ai te këta personazhe që e tërhiqnin kaq shumë?

- Besoj i pëlqente kodi, besnikëria, forca, burrëria. Ata ishin personazhe që nuk nënshtroheshin kollaj.

Elvisi hesht pak dhe pastaj më kujton një bisedë tonën të mëparshme, një kërkesë që në atë kohë më ishte dukur thjesht si një dëshirë e tij për librin, por që tani, duke e dëgjuar të flasë për të atin, fiton një peshë tjetër.

- Duke menduar për librin, kisha një poezi që doja ta skalitja në mermerin ku fle im atë në varreza. U ngulita keq fare me atë poezi. Nuk i vura, sepse në anglisht ishte pak e ndërlikuar.

- Pse mendon se pikërisht ajo poezi të mbajti kaq fort pas vdekjes së babait?

- Vargjet e asaj poezie gjenden edhe në varrin e John Gotti-t. I lexova dhe m'u dukën shumë e të përshtatshëm. Babait do t'i kishin pëlqyer...

Poezia për të cilën fliste Elvisi ishte "Mos qëndro buzë varrit tim e vajto", e Mary Elizabeth Frye. Ia kisha përkthyer me kërkesën e tij dhe, kur e rilexoj në dritën e kësaj bisede, e kuptoj më mirë përse kishte ngulur këmbë pikërisht te këto vargje.

Mos qëndro buzë varrit tim e vajto

Mos qëndro buzë varrit tim e qaj,
S'më gjen dot atje, nuk fle, ndaj!
Jam mijëra fllade ere që fryjnë lehtë,
Vezullim diamantesh mbi borën krejt.

Jam drita e diellit mbi grurin e pjekur,
Jam shiu i butë i vjeshtës duke rrjedhur.
Kur zgjohesh herët, e bota ende fle,
Jam hov i lehtë zogjsh që rrotullohen në re.

Jam yjet e butë që natën e bëjnë dritë,
Ndaj mos qëndro buzë varrit tim e prit.
S'më gjen dot atje! Mos qaj për mua, jo;
Unë nuk kam vdekur! Ende jetoj!

Ndoshta brenda tyre Elvisi kishte gjetur një mënyrë për ta menduar të atin në pafundësinë e botës. Poezia e shpërndan shpirtin e njeriut në ajër, në dritë, në shi, në borë, në qiell, në lëvizjen e zogjve, duke i dhënë kujtesës një formë që nuk rri e mbyllur në një pikë të vetme. Për një bir që kishte humbur babanë, kjo mund të ishte edhe një mënyrë për t'i rezistuar idesë së mungesës së plotë, për ta mbajtur të atin të pranishëm në botën që vazhdonte.

* * *

Më bën përshtypje ky bashkim i pazakontë i gjërave që Elvisi sjell njëra pas tjetrës: kirurgjia, poezia, muzika, shahu, boksi, filmat, gangsterët, kodi i besnikërisë dhe tërheqja ndaj personazheve të forta. Njeriu i vërtetë është pothuajse gjithmonë më interesant se profili që përpiqemi t'i ndërtojmë. Nga kjo botë e brendshme, biseda kalon natyrshëm te mënyra si Agimi i zgjidhte njerëzit.

- Kur e mendoje babanë mes njerëzve, çfarë e bënte të afrohej me dikë? Çfarë kërkonte tek të tjerët dhe pse krijonte lidhje edhe me njerëz që mund të ishin shumë larg botës së tij profesionale, shoqërore apo kulturore?

- Ishte një njeri ndryshe nga të tjerët, nga kolegët e tij, - thotë Elvisi. - Sot e shihje me profesorë. Të nesërmen me gjeneralin Nehat Kulla. Kishte shokë që të tjerët mund të mos i donin, por Gimi i donte. Nuk e merrnin me zor. Ai i zgjidhte.

- Çfarë ishte ajo cilësi që e bënte dr. Agimin ta pranonte dikë pranë vetes?

- Duhej ta donte jetën, të dinte të gëzohej. Atij i ka pëlqyer jeta shumë. Një njeri që do jetën, do ushqimin, do njerëzit. Im atë dinte të notonte në çdo sipërfaqe uji. Ulej me këdo.

- Kjo që the më duket sikur përmbledh një pjesë të madhe të karakterit të tij.

- Dinte të notonte në çdo sipërfaqe uji... Kaq e thjeshtë është!

* * *

Pa nisur regjistrimin, Elvisi më pat folur edhe për një tjetër figurë që e kishte formuar atë vetë. Daja i tij kishte pasur një ndikim të ndjeshëm që në fëmijërinë e Elvisit. Për të mos e humbur nga biseda, ia rikujtoj dhe ai ndriçohet kur e pyes:

- Ti më the se në familje ka pasur edhe një tjetër njeri të lidhur fort me gjuhët?

- Po, ka qenë daja im, Ilir Kroi. Ai ka punuar si përkthyes në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri". Dinte gjermanisht, anglisht, italisht, frëngjisht. Disa prej gjuhëve i kishte mësuar vetë, autodidakt. Nga fundi mësoi edhe hebraishten. Lexonte pa fund. Kishte një etje për dijen. Kur isha tre vjeç, tre vjeç e gjysmë, nisi të më mësonte të lexoja e të shkruaja. Lexoja gazetën edhe mbrapsht. Ma ngacmonte intelektin që në atë moshë. - Qesh. - Daja im ishte përkthyes, e ajo që bënte mbetej një herë e përgjithmonë pasi dilte prej tij. Përkthimi nuk është i lehtë, por në çdo punë nevojitet talent dhe përkushtim.

Edhe këtu dalim te talenti dhe përkushtimi që bëjnë dallimin në karrierën e gjithkujt. E rikthej bisedën te dr. Karaj. Nis t'i flas për një nga emisionet që gjeta në Youtube e që përqendrohet te aktiviteti profesional i doktorit.

- Kur u dha "Gjurmët shqiptare", isha shumë keq, isha me temperaturë. Por ka materiale të tjera për Gimin. - Kërkon në kujtesë. - Ka edhe një... intervistë në Milano. Jo intervistë, më fal. Ka qenë konferencë. Doktori ka dalë përpara profesorëve të mëdhenj atje. Kishte njerëz që habiteshin, një pjesë nuk dinin as ku binte Shqipëria. Dhe del ky, nga Shqipëria, me atë sigurinë e vet... Ah, prit... më kujtohet dhe një emër tjetër... Avni Saliu.

- Kush është ky zotëri?

- Është mjek onkolog nga Australia. Një nga më të mirët. Ka qenë shumë i rëndësishëm edhe për disa lidhje e rekomandime jashtë për dokorin.

E shënoj emrin. Libri hap rrugë të tjera. Secili emër mund të bëhet një derë nga të hyjnë kujtime e materiale me peshë për jetën e dr. Agimit. Elvisi e di këtë.

- Libri duhet të ketë vlefshmëri edhe nesër, - thotë. - Kur ta marrë një lexues në dorë, duhet t'i kthehet mendja te doktor Agim Karaj dhe te Amavita. Sepse këtu është shpirti, fryma, fytyra e tij. Spitali ka fizionominë e doktorit, si ky libër që do të shkruhet në kujtim të tij.

* * *

Kanadaja është një kapitull më vete në jetën e dr. Agimit.

- Atje vuajti me shpirt ndër dhëmbë, derisa ia doli mbanë, - e nis rrëfimin e tij Elvisi. - Punoi punë të ndryshme, punë të rëndomta. Duhej të niste nga e para. Në Kanada, fillimisht, e kishte ftuar një fis nga Zëmblaku, fisi Kulla. Babai i kishte shpëtuar jetën njërit prej tyre. Ata në Shqipëri kishin qenë me damkë nga shteti dhe mjekët e tjerë nuk u afroheshin shumë. Babai nuk e kishte këtë. Ai ishte shumë i ndjeshëm ndaj hallexhinjve. Ata nuk e harruan dhe e ftuan në Kanada. Por kur mbërriti, rrethanat kishin ndryshuar. Edhe ata po humbnin pasuritë. Kështu që Gimi duhej të çante vetë, me aftësitë e veta. Dy vjet ishte kjo barrë e madhe mbi supe. Pastaj hapi picerinë e vet. Sot e ka trashëgim vëllai. Pra Gimi nuk u dorëzua në asnjë moment. Ishte luftarak, largpamës. Nuk priste t'ia bënte dikush tjetër atë që mund ta bënte vetë. - Dhe me atë mënyrën e vet, e përmbledh: - Gim Karajn ta çoje në Sahara, hapte pus dhe gjente ujë...

Më vjen të vë buzën në gaz nga përfytyrimi i doktor Agimit në shkretëtirë. Gjithkush mund të ketë dëshira të mira, por doktor Gimi ka qenë nga ata që po të mos e gjente atë që donte që në fillim, nuk tërhiqej mbrapsht, por përveshte mëngët dhe fillonte të gërmonte i pari.

* * *

Specializimi në Francë ishte një nga etapat që e ndihmoi doktor Agimin të zgjerohej profesionalisht dhe të provonte veten në një mjedis krejt tjetër nga ai që njihte. Dr. Agimi arrinte të afrohej shpejt me të tjerët dhe të krijonte miqësi me një natyrshmëri që dukej se i vinte vetvetiu. Ishte një

cilësi që do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës dhe që do të bëhej pjesë e mënyrës së tij për të hyrë në marrëdhënie me njerëzit.

- Po Franca? - e pyes Elvisin. Jemi ulur në një kafe pranë Amavita-s. Nuk i ndahemi territorit ku gjendet e mbyllur krejt jeta profesionale e tij.

- Në Francë shkoi për specializim. I bëri shokë e miq të gjithë. Ai të bënte për vete. Ishte i ëmbël, i dashur, simpatik, inteligjent. Kishte një vështrim që të depërtonte. - Elvisi ngre dy gishtat drejt syve. - Janë dhunti që t'i jep Zoti. Për më shumë, ai i donte dhe e donin njerëzit. Ishte popullor. Të përthithte të gjithin. E di çfarë thoshin disa nga kolegët e rinj në spital tek ne: "Na lodh ky njeri. Është psikovampir, na thith energjinë!"

- Psikovampir? Pse ky epitet?

- Po, sepse kishte energji të jashtëzakonshme dhe kërkonte të njëjtën gjë nga të tjerët.

- Doktor Agimi i skanonte njerëzit?

- Me një shikim! Ky bën, ky s'bën. Ky është djalë i mirë, ky jo. E kishte si të lindur. Shqisë të gjashtë.

- Dhe gabonte? - e provokoj pak. Nuk dua që Agim Karaj të na shndërrohet në një shenjt letrar pa të meta.

- Sigurisht që do të ketë gabuar në jetë. Njeri ishte edhe ai. Por kishte aq siguri kur thoshte diçka, sa të bënte të mendoje se kishte parë diçka që ti nuk e shihje, ndaj e mira e të mirave ishte ta dëgjoje, e t'i bindeshe.

* * *

Zhurma e rrugës vjen e zbutur deri te tavolina jonë dhe, ndërsa Elvisi flet, mendja më shkon te ime bijë që rritet çdo ditë. Edhe unë jam prind dhe pyes veten si dukem në sytë e saj, sa nga përpjekjet e mia i kupton tani dhe sa prej tyre do t'i marrë vesh vetëm kur të jetë rritur. Ndoshta fëmijët nuk i njohin menjëherë sakrificat e prindërve dhe duke dëgjuar Elvisin, e kuptoj se ka ardhur çasti ta njoh doktor Agim Karajn si babanë e dy djemve të tij.

- Si ishte për ty dhe Endrin të rriteshit me një baba që ishte gjithmonë aty për pacientët, ndërsa jo gjithmonë për familjen?

Elvisi i peshon fjalët para se të përgjigjet. Mbyll pak sytë, sikur do të ndërmende kohën e largët, pastaj thotë:

- E vështirë ka qenë. Më tepër nuk e kemi parë sesa e kemi parë. Puna zinte pjesën më të madhe të kohës së tij. Por mua më merrte zakonisht me vete. Unë isha më i madhi. Donte të më burrëronte, të më nxirrte të fortë dhe të mos trembesha nga jeta. Ai kishte strategji për çdo gjë. Në çdo lëvizje ishte tre-katër hapa përpara. I kishte gjërat të përllogaritura. Nuk bënte lëvizje bosh. Nuk punonte kot, nuk lëvizte kot, nuk mendonte kot. Çdo gjë e kishte një qëllim. Kur e kuptova unë, me vonesë... kishte dalë e tija.

- Por mungesën e keni vuajtur ti dhe vëllai?

- Patjetër. Babai nuk ishte me ne gjithë kohës. Ka pasur ditëlindje të miat ku nuk vinte se ishte në operacion. Kjo më lëndonte, isha fëmijë. Por kur ndodhej pranë nesh, im atë tregohej i dashur, alegro, plot jetë e gjallëri. Unë kisha krenarinë që isha djali i doktor Agimit. Edhe sot e kësaj dite vazhdon ajo ndjesi. Kudo që shkoja, sapo merrnin vesh që isha djali i doktor Gimit, ndryshonte qëndrimi. Më respektonin. Më merrnin me të mira. Polici, dyqani i lagjes, kudo. Edhe kur isha i vogël, mua nuk më mungonte gjë. Ishin kohë të vështira, por ai kishte atë lloj pune ku njerëzit ndonjëherë nuk jepnin lekë. Jepnin çfarë kishin. Vezë, pula, gjëra nga shtëpia. Ishte mënyra e tyre për ta falënderuar. Shokët ma kujtonin vazhdimisht privilegjin. Më thoshin: "Ti ke lindur me këmishë të kuqe." Kjo shprehje më ndoqi gjithë jetën. Edhe sot: "Ke lindur me këmishë të kuqe."

- Ti e pranon e nuk të mërzit aspak ky përcaktim?

- Çdo gjë që kam unë sot në jetën time është falë atij. Edhe sot i dëgjoj fjalët e tij çdo ditë. E kaloj shiritin në mendje. Kur bëj gabime. Kur e teproj pak me alkoolin, sikur e kam para syve: "Mjaft pive, se s'di të pish." *Dua ta pyes më tepër për këto ndjesi të lidhjes familjare. Sikur të më lexonte në mendje, Elvisi vazhdon vetë:* - Por dua të shtoj që babai me mua i ka pasur punët. Për vëllain më vjen keq. Endri nuk mori gjithmonë vëmendjen që duhej. Unë bëja problemet. Ai u fokusua tek unë. Vëllai ishte i qetë, i urtë, asnjë problem. U rrit i mirë, i aftë. Dhe pikërisht sepse ishte mirë, ndoshta dukej sikur nuk kishte nevojë.

- Ndërsa ti nuk kishe?

- Unë isha i llastuar. I bija pianos, isha nxënës i mirë. Pastaj bëra edhe çapkënllëqet e mia.

- Doktori e kuptoi ndonjëherë se Endrit i kishte munguar kjo vëmendje?

- Nga fundi, po... E kuptoi që me vëllain duhej të ishte sjellë më mirë... Për të njëjtën gjë po akuzohem unë tani në familjen time, nga fëmijët e mi.

- Se je shumicën e kohës larg tyre?

- Po, jam në lëvizje, me punët, me njerëzit, me hallet e të tjerëve. Kam shumë pak kohë për gruan dhe fëmijët e mi...

Eh, jeta, them me vete... Historia familjare ka mënyra të çuditshme për të përsëritur veten, pafundësisht.

* * *

Marrëdhënia e Elvisit me të atin nuk mund të tregohet vetëm përmes mallit dhe krenarisë. Mes tyre ka pasur edhe përplasje të forta, periudha heshtjeje, kokëfortësi të dyanshme dhe ato plagë që në një familje nuk mbyllen gjithmonë atëherë kur ndodhin, por shumë vite më vonë, kur njeriu kthehet pas dhe fillon t'i shohë ndryshe.

- Unë kam qenë i prapë, - thotë Elvisi. - Doktori ishte sanguin, nuk të falte kollaj dhe, duke qenë një njeri që kishte arritur shumë me forcat e veta, kishte pritshmëri shumë të larta edhe për fëmijët. Ai mendonte se ne duhej të arrinim, të mos humbnim kohë, të mos shpërdoronim mundësitë që kishim. Një periudhë e lashë shkollën. Kisha atë fazën kur doja të dukesha, të hiqesha si gangster, të bëja të fortin. Edhe këtë, po të duash, e kisha parë pak tek ai, sepse babai kishte një botë shumë të gjerë rreth vetes. Gjatë ditës rrinte me profesorë, me njerëz me kollare, me kolegë e njerëz të rëndësishëm, ndërsa në darkë mund ta shihje me njerëz krejt të tjerë, me të fortët e kohës. Ai dinte të rrinte me të gjithë dhe unë i shikoja këto gjëra. Përplasjet me mua kanë qenë, sepse donte më të mirën. Ai kishte parë diçka tek unë dhe nuk u dorëzua asnjëherë. Shkollën time e kishte peng. Deri në fund më thoshte: "Shko në universitet në Kosovë, shko diku, vetëm të bëhesh mjek. Ta paguaj unë shkollën." Donte të më shihte të sistemuar, të më shihte në një rrugë që për të kishte kuptim dhe siguri.

Kur Elvisi ishte rreth njëzet e dy vjeç, mes tyre pati një tjetër ftohje që zgjati gjatë. Dua të di më tepër nga kjo mëri babë e bir.

- Gati dy vjet nuk kam folur me të. Mëri mbanim të dy. Ai kishte atë karakterin dhe kalkulimet e veta. "S'më flet ai, s'i flas unë." Kështu mendonte. Edhe unë isha kokëfortë, prandaj zgjatej.

- Por ai interesohej për ty?

- Po, gjithmonë. Edhe kur nuk flisnim, më çonte miq, shokë, njerëz që të shihnin si isha. Pyeste për mua. Donte ta dinte çfarë bëja, ku isha, si po më shkonte jeta. Nuk vinte vetë, sepse krenaria ishte shumë e fortë, edhe nga ana e tij, edhe nga ana ime. Mamaja më tha: "Nuk është mirë. Rri afër babit. Është babi yt." Atëherë u ktheva në Shqipëri dhe fillova të jem më pranë prindërve. Nuk ndodhi sikur shtypëm një buton dhe çdo gjë u rregullua menjëherë. Me doktorin u puqëm me vështirësi. - Bën një pauzë dhe buzëqesh lehtë. - Por u puqëm si duhet.

Më pëlqen fjala. Nuk thotë "u pajtuam". Përsërit: "U puqëm". Dy pjesë që pas shumë vitesh rezistence gjejnë më në fund vendin ku mund të bashkohen.

- Çfarë ndryshoi pas kthimit?

- U poqa unë. Besoj se kjo ishte kryesorja. Fillova ta shijoja shumë të qenit pranë tij dhe erdhi një moment kur i thashë vetes se do të rrija me babën tim, se nuk doja t'i krijoja më probleme dhe se, në një farë mënyre, doja t'ia shlyeja edhe ato dëme që mendoja se i kisha bërë dikur. Fillova ta kuptoja më mirë edhe karakterin e tij, prandaj ia durova edhe huqet. Njerëzit që bëhen vetë, nga hiçi, me shpatullat e tyre, bëhen shumë të fortë dhe shpesh nuk e çajnë kokën kollaj për mendimin e të tjerëve. Doktori ishte jashtëzakonisht konfident, robust, hijerëndë. Autoritetin nuk e kishte të sajuar, e kishte krijuar profesionalisht. Mjaftonte të hynte në një vend dhe e ndieje. Pastaj kishte miq në çdo shtresë, në politikë, në biznes, mes njerëzve të rrugës, edhe mes atyre që të tjerët mund t'i quanin gangsterë. Shpesh lidhjet kishin lindur, sepse kishte kuruar një njeri të familjes së tyre dhe prej aty kishte mbetur respekti. Babai dinte të krijonte marrëdhënie dhe t'i ruante gjatë ato.

Tetëmbëdhjetë vitet e fundit të jetës së Agim Karajt i gjetën shumë pranë njëri-tjetrit. Sa më shumë rëndohej shëndeti i doktorit, aq më tepër ndryshonin edhe rolet mes tyre. Djali që dikur ishte rebeluar ndaj autoritetit të të atit filloi të merrte mbi vete gjithnjë e më shumë gjëra të jetës së tij të përditshme.

- Nga fundi isha gjithçka për të. Shofer personal, badigard, isha natë e ditë pranë tij. I lidhja këpucët. Isha i gjithi në shërbim të tij.

Dhe papritur më rikthehet pamja e fillimit. Këpucët pa shollë të fëmijës, që zëvendësohen nga këpucët e plakut, që ia lidh i biri, me duart e tij...

* * *

Në Amavita, koha e doktor Agimit kishte një ritëm të vetin. Ora nuk ndahej qartë në mëngjes, pasdite dhe natë, sepse puna hynte natyrshëm në çdo pjesë të ditës. Kishte krijuar aty edhe një hapësirë ku mund të qëndronte, të pushonte pak, të zgjohej herët dhe të zbriste sërish mes pacientëve, stafit dhe gjithçkaje që kërkonte vëmendjen e tij.

- Doktori ishte punë-punë, - tregon Elvisi. - Këto tetëmbëdhjetë vitet e fundit, në ekstrem. Në Amavita kishte bërë edhe një apartament. Rrinte këtu. Nuk shkonte gjetiu. Flinte në spital. Ishte mjek roje edhe kur nuk ishte mjek roje. Dilte në tre të natës dhe kontrollonte punën. Surprizonte infermierët, stafin, rojet e parkimit.

- Në tre të natës?

Buzëqesh.

- Pastaj çohej tamam në gjashtë, zbriste poshtë, pinte kafen, takonte njerëz. Dhe më merrte në telefon: "Alo, ku je? Eja në punë. Çohu." Unë mërzitesha nga ana tjetër. Ma prishte gjumin pa dalë dielli... Por tani që nuk jeton më, më ka mbetur i ngulitur si ritual. Çohem në pesë e dyzet e pesë çdo ditë.

- Doktori kishte rituale të tijat?

Në mesditë, një zakon i përhershëm. Pinte një kafe te "Sofra e Ariut". E kishte relaksuese. Pastaj kthehej prapë në punë, nga ora tetë deri në katër e gjysmë bënte vizita. Pastaj sallë operacioni deri në përfundim. Kjo, e përsëritur çdo ditë, deri në vitin 2015 kur doli në pension.

- Në pension?! - ia kthej me habi.

Elvisi vë buzën në gaz.

- Vetëm në letra. Nga 2015 deri në 2024, kjo ishte jeta e tij. Edhe më parë nuk kishte qenë ndryshe. Kur ishte shef te Onkologjiku, dilte që në orën shtatë nga shtëpia. Bënte vizitat, operacionet deri në tre. Pastaj vinte këtu dhe punonte. Puna ishte jeta e tij.

E vështirë të dallosh ku mbaronte profesioni dhe ku fillonte njeriu. Ndoshta tek doktor Agim Karaj nuk kishte kufij të qartë midis...

* * *

Kur biseda shkon te Hëna Karaj, toni i Elvisit zbutet. Figura e nënës hyn në rrëfim me një lloj drite tjetër, sepse bashkë me historinë e dashurisë mes saj dhe Agimit hapet edhe një pjesë më e dhimbshme e kujtesës familjare, e lidhur me një kohë kur njerëzit mund të jetonin pranë njëri-tjetrit dhe, megjithatë, të detyroheshin të qëndronin larg.

- Si janë njohur prindërit e tu? - e pyes Elvisin.

- Janë parë dhe janë pëlqyer. Babai ka pyetur menjëherë se çfarë vajze ishte dhe i kanë thënë: "Shumë e mirë. Mos luaj me të." U lidhën dhe ai e donte shumë.

Elvisi e përshkruan të ëmën me një butësi që ndihet në zë.

- Mamaja ka qenë shumë e bukur në rini, si franceze. Dhe është njeri shumë i mirë. Gimi donte një grua me cilësi të rralla. Edhe familja e saj ka një histori të fortë. Nëna vjen nga një familje e lidhur me Avni Rustemin, nga Libohova dhe Gjirokastra, me mbiemrin Spahiu.

Rikthehemi te doktor Agimi dhe, pa e kuptuar, biseda afrohet te një nga temat që e kishte ndjekur gjatë gjithë jetës profesionale. Kam ndër mend betejat e tij të përditshme me sëmundjen e shekullit, me atë fjalë që mjafton të shqiptohet dhe të ndryshon ritmin e frymëmarrjes. "Kancer" është një nga ato fjalë që, edhe para diagnozës së plotë, mbart brenda ankthin, pasigurinë dhe hijen e vdekjes. Doktor Agimi e kishte parë këtë frikë në sytë e mijëra pacientëve, e kishte sfiduar në sallën e operacionit dhe kishte jetuar për vite me praninë e saj. Më lind natyrshëm pyetja se

çfarë ndodhte kur kjo fjalë kthehej nga ana e tij, kur nuk bëhej më fjalë për pacientin, por për vetë njeriun.

- Po vdekjen e tij, e mendonte, e përmendte doktori?

- E kishte tmerr. Nuk e kishte qejf fare si temë dhe përpiqej ta shmangte. Një herë ishim në makinë, im atë po këmbëngulte në diçka që mua nuk më rrinte mirë dhe, i acaruar, në një moment shpërtheva: "O bab', shih varrezat." Nuk duhej ta kisha bërë. E kuptova menjëherë që e preka aty ku nuk duhej. Ai e kishte shumë të vështirë këtë pjesë dhe, sidomos nga fundi, frika u shtua. Kishte raste kur thoshte se nuk donte t'i shkonte më askujt për vaki. Sikur edhe vetë prania e ceremonive mortore t'ia sillte shumë afër diçka që donte ta mbante larg.

- Pse një njeri që gjithë jetën e kishte parë vdekjen nga afër nuk donte ta përmendte kur bëhej fjalë për veten?

- Për të, vdekja nuk ishte ide abstrakte. Ishte diçka që e shihte përballë, në trupin e pacientëve, në analizat, në sallën e operacionit, në familjet që prisnin jashtë. Dhe të punosh për vite në një fushë të tillë është psikologjikisht shumë e rëndë. Unë e shoh edhe me veten time. Ne trajtojmë çdo ditë kancer dhe ka netë që shkoj në shtëpi e mezi më zë gjumi. Njeriu nga jashtë mendon se mjeku mësohet, se pas disa vitesh e humbet ndjeshmërinë, por nuk ndodh kështu. Ne nuk jemi prej çeliku. Përkundrazi, gjithçka grumbullohet diku brenda dhe të gjitha lënë gjurmë, e me kalimin e kohës, pesha të kërrus edhe ty. Im atë ishte njeri praktik, nuk i pëlqente të filozofonte gjatë për vdekjen, as të rrinte e të pyeste ku shkon shpirti, çfarë ndodh më pas. Ishte shumë i lexuar, shumë shkencor dhe ishte rritur në një periudhë ateiste, ndaj edhe mënyra si e shihte botën vinte shumë nga arsyeja, nga shkenca, nga gjërat që mund të provoheshin. Por unë mendoj se është mirë të besosh. Besimi të jep një lloj ngushëllimi që shkenca nuk ta jep gjithmonë.

- Pse? - e pyes gjithë kërshëri.

- Them se besimi të ngushëllon dhe të ndihmon t›i japësh kuptim ekzistencës. Kaq duhet të mjaftojë për çdo njeri...

* * *

Njeriu jeton me një bindje të heshtur se e ardhmja i detyrohet të paktën edhe një takim. Regjistrimi i bisedës së fundit me Elvisin mbyllet duke lënë zërin e tij të dridhet edhe pak sekonda në ajër. I njëjti zë që atë ditë më dukej aq i natyrshëm, sa ishte e pamundur ta mendoje të veçuar nga trupi i burrit të gjatë, nga sytë e kaltër, nga buzëqeshja që dilte lehtë, tani është pjesë e kujtimeve ndaj jetës së Elvis Karajt. Ky libër nisi nga dëshira për të dokumentuar në kujtimet e njerëzve që e patën njohur nga afër, jetën e doktor Agim Karajt. Askush prej nesh nuk e dinte se gjatë rrugës do të merrte mbi vete edhe një tjetër humbje.

Elvis Karaj u nda papritur nga jeta në moshën dyzet e tetë vjeç.

Dyzet e tetë...

Një moshë kur fjalët shqiptohen ende në kohën e ardhme. Një moshë kur fëmijët ende kanë nevojë për babanë dhe babai beson se ka kohë t'u shpjegojë nesër ato që sot nuk arriti.

Pas tij mbeti Dalina, bashkëshortja.

Mbetën tre fëmijët e tyre, dy vajza dhe një djalë.

Mbeti Endri, vëllai me të cilin kishte ndarë fëmijërinë dhe gjithçka që vetëm dy vëllezër mund ta dinë për njëri-tjetrin.

Dhe mbeti Hëna, nëna e tij... Nuk di një fjalë që mund ta mbajë peshën e humbjes në zemrën e nënës. Ndoshta nuk ka.

Mbetën familjarë, miq pa fund, njerëz që Elvisi i kishte bërë pjesë të jetës së vet me atë dhuntinë e trashëguar për të hyrë te njerëzit.

Dhe mbeti regjistrimi im.

E shtyp butonin, vë veshin të dëgjoj për herë të fundit dhe zëri mbush dhomën. Gjatë intervistës isha unë ai që e ndërprisja, e ngacmoja, e nxisja me ndonjë pyetje, tërhiqesha kur kujtimi bëhej i rëndë dhe kthehesha përsëri nga një drejtim tjetër. Regjistrimi i bisedës kumbon në dhomë. Po flet Elvisi. Kemi qenë në Amavita-n e tij, ka qëndruar përballë meje, me vështrimin e kaltër dhe buzëqeshjen e çiltër. Unë kisha nisur të regjistroja zërin e Elvisit që të ruanim kujtimin e të atit, pa e ditur që kështu po ruaja përjetësisht edhe zërin, shpirtin, esencën e tij.

DITËT E MIA PA TY
- me Hëna Karaj (Kroi) -

Pikërisht tani
Ti më do më shumë
Pikërisht tani!
Kur hapat ecin zvarrë
Dhe s'i ndaloj dot unë
Pikërisht tani!

Pikërisht tani
Kur dorën ta kam zgjatur
Pikërisht tani!
Pas dorës tënde
Që ta mbaja kapur
Siç ma mbaje dhe ti![1]

Pas dekadash të jetuara pranë dikujt, humbja prek gjithë arkitekturën e jetës së përbashkët. Ajo hyn në zakonet e ditës, në dhomat e shtëpisë, në oraret e krijuara prej vitesh, shndërrohet në një mungesë që ka marrë prej teje diçka thuajse fizike. Çfarë ndodh me jetën e një njeriu kur humbet partnerin që ka qëndruar për dekada pranë tij? Si vazhdohet përpara kur një pjesë e historisë në çift jeton tashmë vetëm në kujtesë dhe çdo rikthim

1. Skënder Rusi, Poezi të zgjedhura, Botimet Schnell, Tiranë, 2023

pas sjell me vete fytyrën, zërin, zakonet dhe praninë e atij që ka ndarë me ty pjesën më të madhe të rrugës?

Hëna Karaj ka qenë pranë dr. Agimit për dekada dhe, përmes kujtesës së saj, do të mund të shihja një pjesë të jetës së doktorit që nuk e dinte kush. Futemi në një nga hapësirat e reja të Amavita-s, një studio që përdoret herë pas here për konsulta dhe që është pjesë e shtesave të realizuara nga Elvisi për të zgjeruar spektrin e shërbimeve të spitalit. Ka diçka domethënëse në faktin që kjo bisedë zhvillohet pikërisht këtu, në një mjedis që mban gjurmën e vazhdimësisë së asaj që Agim Karaj kishte nisur dhe që i biri kërkonte ta çonte më tej, duke i shtuar spitalit hapësira, funksione dhe mundësi të reja.

Në godinën përballë vazhdon ritmi i zakonshëm i Amavita-s. Pacientët vijnë dhe ikin të ngarkuar me ankthin, shpresën, lodhjen, por edhe lajmet e mira në sy. Brenda studios ku do të zhvillohet biseda jonë, koha do të ecë në drejtimin tjetër. Do të kthehemi vite pas, te një jetë që nisi shumë përpara Amavita-s. Zonja Karaj ka ardhur e shoqëruar nga motra e saj, Valentina. Që në çastin e parë e kuptoj arsyen e kësaj zgjedhjeje. Hëna e di se do të flasim për një jetë të tërë dhe se brenda saj ka kujtime që sjellin gëzim, të tjera që rëndojnë dhe disa që mund ta bëjnë njeriun të humbasë për një çast kontrollin mbi emocionin. Por shumë shpejt kuptoj se Valentina, apo Vali, siç e thërret shkurt Hëna, nuk ka ardhur vetëm për t'i qëndruar pranë motrës. Edhe ajo ruan një mori kujtimesh me doktor Agimin, sepse ka qenë pjesë e jetës së familjes, ka parë nga afër marrëdhënien e tyre, ka dëgjuar biseda, ka ndarë gëzime e shqetësime dhe ka ruajtur episode të çmuara në mendje. Që në fillim e kuptoj se intervista ime me znj. Karaj do të kthehet natyrshëm në një bisedë me dy zëra, ku kujtimet e njërës do të plotësojnë ato të tjetrës.

Dua që biseda të nisë larg ditëve të fundit. Ka një jetë të tërë përpara tyre dhe pikërisht aty dua të hyjmë: te njohja, te Agimi i ri, te martesa, te familja që u krijua, te vështirësitë e fillimit, te fëmijët, puna, largimet dhe kthimet, Kanadaja, mjekësia, Amavita, miqtë dhe gjithë ajo kohë gjatë së cilës dy njerëz mësojnë të ecin së bashku deri sa prania e njërit bëhet pjesë e mënyrës si tjetri e kupton vetveten. Vendos regjistruesin

mbi tavolinë dhe shtyp butonin e regjistrimit. Më intereson të kuptoj gruan që kam përballë.

- Znj. Karaj, dua të nisemi nga shtëpia ku jeni rritur. Çfarë familjeje ishte ajo, çfarë njerëzish ishin prindërit tuaj dhe çfarë kujtoni si frymën më të fortë të asaj shtëpie?

- Unë kam pasur fatin e keq të jetoj ndarjen e nënës me babain tim që në moshë fare të vogël. Mami kishte mbaruar për rusisht dhe punonte si përkthyese në Ambasadën Kineze. Babai kishte studiuar pesë vjet në Leningrad, ishte oficer madhor dhe punonte me gradë, tek ajo që më vonë u njoh si "Shtëpia me Gjethe". Ishte nga familja Spahiu. Pastaj filluan dënimet për lidhjet familjare dhe u godit gjithë fisi. Babai u dënua edhe për gjëra që sot të duken të pabesueshme. Kishte jetuar jashtë dhe një herë kishte thënë se këpucët çeke ishin shumë të mira, ndërsa ato shqiptare ishin të dobëta. Edhe një fjali e tillë mund të kthehej në problem në atë kohë.

Nga ana e nënës, familja ndodhej shumë pranë strukturave më të larta të shtetit. Haxhi Kroi kishte qenë sekretar i Enver Hoxhës, një dajë tjetër ambasador, ndërsa Kiço Kasapi, bashkëshorti i tezes, kishte mbajtur postin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave. Dy anë të së njëjtës familje gjendeshin papritur në skaje të kundërta të një sistemi që nuk linte shumë hapësirë për jetën private.

Ja ku jemi, në gjellën e gatuar në shumë familje shqiptare të kohës së komunizmit, ku një lugë e hidhur mund të prishte gjithë mundin e gatitjes së ushqimit për familjen. E inkurajoj me sy të vazhdojë rrëfimin dhe znj. Karaj vijon:

- Nënës i kërkuan të ndahej nga babai. U ndanë dhe babai hyri në burg. Ne ishim tre fëmijë. Mami im ka qenë heroinë. E them me bindje, sepse mbajti mbi vete shumë gjëra. Familja e saj vinte nga Libohova, ishin nipër të Avni Rustemit, njerëz shumë të edukuar dhe shumë tolerantë. Mamaja kishte ardhur në Tiranë që pesë vjeçe dhe e kishte atë lloj formimi që të mësonte të mos e humbisje masën edhe kur jeta të vinte përballë gjërave të rënda. Por vendimi i saj ishte i nxituar edhe nga im atë, që e njihte mirë sistemin ku punonte dhe kjo ishte mënyra e vetme që të mos prekeshim ne, fëmijët.

Nuk dua që të shkëputem nga tema qendrore e bisedës, ndaj ndryshoj drejtimin e bisedës dhe e pyes:

- Si hyri dr. Agimi në jetën tuaj?

Hëna, buzëqesh dhe ndryshimi i atmosferës ndihet menjëherë.

- Me Gimin jam njohur krejt rastësisht, në Qytetin Studenti. Një shoqe e imja duhej të takonte një doktor dhe më kërkoi ta shoqëroja. Gimi atëherë ishte në vitin e gjashtë të Mjekësisë dhe ndërkohë e kishin angazhuar si mjek në ambulancën e Qytetit Studenti. Ishin dy mjekë, njëri nga Skrapari, Qazimi, dhe tjetri Gimi. Unë qëndrova pak më larg, nuk kisha ndonjë interes të veçantë të afrohesha. Shoqja ime shkoi të fliste me të dhe ai, ndërsa bisedonte me të, më kishte parë. "Kush është ajo goca?" - e kishte pyetur. Shoqja i kishte thënë se ishte një vajzë tiranase. "Ma prezanto me patjetër", - kishte këmbëngulur Gimi. "Ik se nuk është për ty, të tallesh", - ia kishte kthyer ajo. Pas pak, Agimi u afrua vetë.

Hëna, qesh kur rikthen atë çast, sepse kujtesa ka zgjedhur të ruajë një hollësi që sot duket pothuajse komike.

- Gimi ka qenë shumë i çrregullt si tip. Nuk kishte qejf të mbahej. Elvisi, për shembull, ishte krejt ndryshe, shumë më i rregullt. Gimi ka qenë më i shkujdesur. Atë ditë kishte veshur një pardesy dhe kopsat i kishte mbërthyer gabim. Njëra anë i rrinte më e gjatë, tjetra më e shkurtër. Mua më ra menjëherë në sy dhe, të them të drejtën, kjo ishte përshtypja e parë që më la. Kur mbeta vetëm me shoqen time, ajo më tërhoqi nga krahu e më tha: "Ky më duket se të pëlqen ty." Por aty për aty, unë ia ktheva u menduar: "Ik moj, ai me ato kopsa ashtu!"

Nga gjithë ai takim i parë, kujtesa i kishte ruajtur pikërisht pardesynë me kopsat e mbërthyera shtrembër. Por dr. Agimi e kishte vendosur kush do të ishte bashkëshortja e jetës së tij.

- Edhe herë të tjera më dilte përpara me biçikletë kur shkoja në shtëpi. Shikonte me kë takohesha, më vëzhgonte, kërkonte mënyrën të afrohej. Një ditë po shkoja në qendër, në klinikën e Skënder Topullit, te një dentist. Ai ishte me biçikletë dhe më pyeti ku po shkoja. Pastaj më tha të bënim rrugën bashkë dhe dolëm në bulevard. Dhe atë ditë bëri diçka që mua më tërhoqi menjëherë. Filloi të fliste frëngjisht. Gimi në atë kohë e fliste

shumë mirë. Unë kam qenë ndryshe: po nuk e mësova mirë një gjuhë, nuk e flas. Gimi guxonte, ia fuste si t'i vinte në mendje, nuk kishte frikë të gabonte. Filloi të fliste dhe unë vazhdova me të frëngjisht. Folëm gjatë. Aty kuptova se ai kishte gjetur elementin që na bashkonte.

Tingujt e gjuhës frënge, sikur u përhapën një hop në ajër, me atë melodinë që ka kjo gjuhë për të afruar shpirtrat me njëri-tjetrin. Hëna vazhdoi rrëfimin:

- Mua më këputi ai detaj, sepse aty tregoi veten. Ai kishte parë, kishte menduar dhe kishte kuptuar se frëngjishtja ishte pika jonë e përbashkët. Kishte gjetur çelësin e duhur dhe qëlloi në shenjë.

I them se kam parë fotografi të Agim Karajt në rini dhe se kishte qenë një djalë i pashëm. Hëna ma pret mendimin menjëherë:

- Nuk ishte kjo ajo që më goditi, por e folura, komunikimi i tij, intelekti. Unë edhe burrin e ëndrrave e përfytyroja vetëm të mençur. Bukuria nuk ishte ajo që më bënte përshtypje, ndërsa te Gimi më tërhoqi mënyra si mendonte dhe si fliste.

Frëngjishtja kishte hapur rrugën e parë mes tyre, por në jetën e Agimit ajo kishte hyrë shumë më herët. Ndaj e pyes kush i kishte çelur dyert e kësaj gjuhe dr. Agimit.

- Gimi pati fatin të kishte komshie zonjën Meli. Ajo ishte shumë e kulturuar, i binte edhe pianos dhe e nxiste të mësonte frëngjisht. I jepte libra, i fliste, e ndihmonte. Gimi mori prej saj bazën, pastaj për pesë apo gjashtë vjet shoqëroi turistë të huaj. Merrte gjithmonë një bllok me vete dhe, kur dëgjonte një fjalë që nuk e dinte, e shënonte. Natën kthehej, e kërkonte, e mësonte dhe të nesërmen e përdorte. Kështu nuk mësoi vetëm frëngjishten e librave, por edhe gjuhën e folur, shprehjet e përditshme, zhargonin. Ishte mënyra e tij për të mësuar: dëgjonte, shënonte, provonte dhe nuk kishte frikë të futej në bisedë. Në një nga ato udhëtime kishte ndodhur edhe një episod që Agimi ma tregoi më vonë. Ishte vapë dhe ai kishte veshur një kostum të zi, jo fort të përshtatshëm për temperaturën, por ishte një nga ato veshje që kishte siguruar me vështirësi dhe donte të paraqitej mirë përpara turistëve. Kur po hipte në autobus, shoferi ia kishte mbyllur derën përpara fytyrës, duke e kthyer çastin në një shaka të

keqe. Turistët prisnin brenda dhe Agimi ishte ndier i fyer. Më vonë i tha shoferit: "Ti bëre gabim." Ai i kërkoi falje Gimit dhe pastaj ndodhi ajo që ndodhte shpesh me të: u bënë shokë. Gimi mund të mërzitej në çast, por nuk e mbante gjatë. Dinte ta kthente një situatë dhe të merrte nga njeriu atë pjesë të mirë që kishte.

* * *

Dr. Agimi vazhdonte ndërkohë të mbushte bllokun e vogël me fjalët e reja. Ditën dëgjonte, natën mësonte, të nesërmen provonte përsëri. Frëngjishtja do ta shoqëronte më pas në udhëtime, në lexim dhe në profesion.

- Çfarë kujtoni nga shtëpia e doktorit dhe, mbi të gjitha, nga familja e tij?

- Shtëpia ishte shumë e thjeshtë, një dhomë dhe një kuzhinë, shumë e vogël. Gimi rrinte më tepër në Qytetin Studenti. Në shtëpi komandën e kishte mamaja e tij. Ishte impulsive, kishte temperament, por ishte jashtëzakonisht e zgjuar. Unë them gjithmonë se, po të ishte gjallë sot, ajo do të ishte supermilionere e Shqipërisë. E nxirrte lekun nga guri. Nuk dinte të rrinte. Blinte lesh, e tirrte ndërsa bisedonim, e ngjyente, bënte qilima dhe pastaj i shiste. Mund të ishe ulur duke pirë kafe me të dhe duart i punonin gjithë kohën. Ajo shihte mundësi kudo dhe gjente një mënyrë që shtëpia të ecte përpara.

Këtu më rikthehet një pjesë nga biseda me Elvisin. Edhe ai, kur fliste për gjyshen, e vendoste menjëherë në qendër të familjes. E quante "shtylla" e shtëpisë, gruan që kishte marrë frenat në një periudhë të vështirë dhe që kishte një inteligjencë natyrore të jashtëzakonshme. Duke dëgjuar tani Hënën, figura e asaj gruaje merr më shumë ngjyra.

- Mendoni se Agimi mori prej saj diçka që e shoqëroi gjithë jetën?

- Ajo ka ndikuar te të gjithë fëmijët, por te Gimi ndikimi ka qenë i madh. Nëna e tij dinte të të psikologjiste. Të shikonte, kuptonte temperamentin tënd dhe pastaj gjente mënyrën si të sillej me ty. I përshtatej njeriut dhe situatës. Gimi e kishte shumë këtë cilësi. Ai mund të ulej me një ministër dhe pas pak me një karrocier, dhe në të dyja rastet ta ndiente veten

njësoj. Ministrin e Tregtisë e kishte shok, por kjo nuk e pengonte të lidhej menjëherë edhe me një punëtor. Nuk e maste njeriun nga posti.

- Ju vetë ishit po aq e hapur me njerëzit?

- Jo, unë kam qenë më e tërhequr. Unë isha "step by step", hap pas hapi. Duhej ta njihja njeriun, ta shihja. Gimi nuk e çante kokën fare për këtë. Ai lidhej menjëherë. Nëse i pëlqente dikush, e afronte dhe kaq.

Në vitet kur Agimi punonte edhe në aksione vullnetare në Porcelan, ishte njohur me njerëz që do ta ruanin gjatë miqësinë me të. Mes tyre Hëna përmend doktor Fori Zhupën nga Korça. Kur erdhi koha që të vendosej për një banesë, njerëzit e fabrikës u ngritën për të.

- U ngrit gjithë Porcelani dhe dha votën pro Gimit që të merrte shtëpi. E donin shumë. Ai kishte një motor dhe me atë motor mbaronte hallet e të gjithëve. Nëse dikush kishte nevojë për diçka, ai hipte dhe shkonte. Nuk ruante distancë dhe tregohej i gatshëm në çdo kohë.

Kjo mënyrë e tij për t'i futur njerëzit shpejt në rrethin familjar vazhdoi edhe kur jeta ndryshoi. Hëna kujton një familje nga Tepelena, të lidhur fillimisht me Agimin përmes një pacienteje. E çuditshme si doktori e thyente kufirin që ruante territorin e familjes dhe i bënte pjesë edhe pacientët në përditshmërinë e tij.

- Edhe sot ruajmë miqësi me fëmijët e saj. Atëherë unë u ktheva nga shkolla dhe i gjeta në shtëpi. Bëhej fjalë për një paciente që do të kurohej nga Gimi, por nuk kishin mundësi ekonomike. Im shoq i kishte sjellë në shtëpi, e unë u shtrova drekën dhe aty filloi miqësia. Kur shkonte më vonë Gimi në Tepelenë, shkonte edhe te shtëpia e tyre. Ai kështu i krijonte marrëdhëniet.

Kufiri mes jetës profesionale dhe asaj private te Agim Karaj ishte i hollë. Pacienti mund të bëhej si njeri i afërt, e kjo qasje personale kishte një ndikim të drejtpërdrejtë edhe të mënyra si përballohej sëmundja më pas.

- Cila ka qenë periudha që ju ka lodhur më shumë si bashkëshorte?

Një nga periudhat më të vështira ka qenë ndërtimi i shtëpisë sonë dykatëshe. Historia nis nga një prej atyre bisedave që Agimi dinte t'i kapte në ajër. Një ditë, te kafe "Arbëria", kishte dëgjuar se para viteve

’90 ekzistonte mundësia të ndërtohej shtëpi private. Informacioni për dikë tjetër mund të kishte mbetur një muhabet tavoline, por Gimi u kthye në apartament me planin gati në kokë. E hapi derën dhe më tha: “Hëna, kam ndër mend të ndërtojmë një shtëpi.” “Të ka lënë mendja!”, - ia ktheva unë, por shumë shpejt e kuptova që e kishte seriozisht. Megjithatë, nuk më largohej një ndjesi frike, nga ajo sipërmarrje që vendosi ta çonte në fund im shoq. Në atë kohë nuk ishte si sot, që thua kam tokën dhe ndërtoj. I thosha: “Je në vete? Do të të fusin në burg.” Unë gjithë kohës përpiqesha ta ruaja. Gimi ndërkohë kishte shkuar te kryetari i lagjes, kishte pyetur për ligjin, kishte parë çfarë lejohej. Kryetari i kishte thënë se mund të ndërtohej dhe madje se kishte mbetur edhe një vend i fundit. Për Gimin mjaftonte kjo, ishte si një dritë jeshile se mund të bëhej, e kur e ndante mendjen në fund, nuk kishte vështirësi që t’ia ndalte hapin.

* * *

Martesa mes Agim dhe Hëna Karajt ishte kurorëzuar në vitin 1977. Një vit më pas lindi djali i parë, gëzimi i familjes, Elvisi. Ideja për shtëpinë dykatëshe kishte nisur rreth vitit 1982. Paratë nuk i kishin me shumicë; frigoriferi dhe lavatriçja në atë kohë bliheshin me llotari, ndërsa kursimet e nënës së Agimit u bënë një prej mbështetjeve për të nisur ndërtimin.

- Mamaja e Gimit kishte lekë në librezë dhe na ndihmoi. Kur morëm lejen për ta ndërtuar shtëpinë, vendi që kishim në dispozicion ishte me shkurre, me pemë, baltë e ujë. Duhej të nisje gjithçka nga themelet. Gimi mori njerëz dhe filluan ta pastronin, ndërkohë vazhdonte punën e vet normalisht. Ishte doktor, kishte pacientët dhe detyrimet, pastaj kthehej nga puna dhe merrej me ndërtimin. Jeta jonë për vite u nda mes punës dhe kësaj shtëpie.

Në atë kantier familjar kishte një njeri që Hëna e përmend me shumë afërsi: Gavroshin (Goshin), vëllain e dytë të Agimit.

- Goshi e ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë. Ishin afër në moshë dhe shumë të lidhur. Të dy kishin temperament. Mund t’i dëgjoje në mëngjes duke bërtitur e duke u grindur dhe pas tri orësh i gjeje të përqafuar. Kështu ishin dhe asgjë nuk ua ndryshonte dot temperamentet. Unë me Goshin

kam shkuar si me vëllanë tim. Më donte dhe më respektonte shumë dhe unë ia ktheja me të njëjtin respekt. Kur më vonë familja jonë u zhvendos në shtëpinë e re, apartamentin që kishim më parë ia lamë atij. Gimi i bleu edhe një motor, dyqind e pesëdhjetë mijë lekë. Goshi u kënaq shumë. Sa i shkonte natyrës së tij, të lëvizte rrugëve të Tiranës i shkujdesur e gjithë krenari. E donte motorin dhe i bënte punë.

Ndërtimi vazhdonte mes mungesës së parave, lodhjes dhe një atmosfere që vetëm Agimi dinte ta kthente nga punë në ngjarje. Punëtorët ishin të gjithë të njohur, ndonjëherë edhe miq ose familjarë të pacientëve. Kur mbaronin punë, atmosfera merrte nuancat e mbrëmjes familjare.

- Punonin gjithë ditën. Pas orës tetë unë shtroja darkën, gatuaja, ata hanin diçka dhe pinin ndonjë gotë raki. Gimi kishte sjellë një magnetofon nga Franca. E ndiznim dhe muzika kërciste. Punëtorët ishin lodhur gjithë ditën mes baltës, tullave e punës, por në mbrëmje fillonte muhabeti, rakia, muzika. Të nesërmen komshinjtë më pyesnin: "Mos kishit ndonjë dasmë mbrëmë?"

Hëna qesh nga ky kujtim, sikur jeta e ngrirë e viteve tetëdhjetë të ruante të njëjtën energji dhe shpengim të asaj kohe.

- Gimi e krijonte atmosferën, ndërsa punëtorët linin kokën për të. Dhe kur mbaronte gjithë ajo, ai nuk thoshte tani secili të shkojë vetë në shtëpi. Hipte në motor dhe i shpërndante një nga një, duke i shoqëruar nëpër banesa. Pastaj të nesërmen në mëngjes duhej të ishte në punë në orar. Nuk kishte justifikim se kishte punuar deri natën për shtëpinë.

* * *

Ah, jeta e njeriut, gjithë ç'ka mund të shohim kur marrim ende frymë, është trajta e asaj që presim të dalë në sfond, një grimcë lumturie, ëndrra të kthyera në realitet, frymëmarrje, jetë, jetë... Siç kishte në ato themele ku dr. Agim Karaj nisi ndërtimin e shtëpisë së vet, siç kishte në fytyrat e punëtorëve që i gëzoheshin pushimit duke shijuar muzikën që përcillte magnetofoni i sjellë nga Franca, pastaj rrugët e gjera të kryeqytetit në fund të viteve tetëdhjetë, uturima e motorit me dr. Gimin në timon. Znj. Karaj i ka të gjitha këto ndjesi përbrenda, kur nis të thotë:

- Gimi sillte brigada për ndërtimin e shtëpisë. Ishin vite kur gjithçka dukej sikur ndërtohej njëherësh: shtëpia, familja, puna, një jetë që kërkonte nga të dy energji dhe durim. Shtëpia kishte nisur të ngrihej rreth vitit 1985 dhe, megjithëse kishin hyrë tashmë të jetonin aty, deri në vitin 1991 ende nuk kishte përfunduar. Kishte mbetur punë për të bërë, hollësi për t'u mbyllur, gjëra që prisnin kohën dhe paratë e tyre.

Dhe pikërisht atëherë, kur shtëpia nuk kishte marrë ende formën e plotë të strehës për të cilën kishin sakrifikuar aq shumë, Agimit iu ngul në mendje një tjetër ide.

- Si lindi ideja për Kanadanë?

- Gimit i kishte hipur në kokë dhe donte të ikte. Unë atëherë punoja te Akademia e Shkencave, në bibliotekë. Kisha punën time, kisha fëmijët, kishim shtëpinë që po ndërtonim. Unë nuk dija anglisht. Pra, për mua nuk ishte sikur po mbyllja një derë dhe po hapja një tjetër. Po lija një jetë ku i njihja të gjitha dhe po shkoja drejt diçkaje që nuk e njihja fare. Gimi, ndërkohë, kur e vendoste një gjë, e ndiqte deri në fund.

- U mor vendimi dhe u bë fakt i kryer?

- Po. Në vitin 1991, iku Gimi. U largua i pari që të na bënte vend neve më vonë. Shtëpia që kishim ngritur, ende nuk kishte mbaruar. Ne ishim futur të jetonim brenda, por kishin mbetur shumë gjëra pa përfunduar. Nuk kishim as derë të jashtme. Ta mendosh, e frikshme dhe e trishtë është. Unë isha grua e re, me dy fëmijë të vegjël dhe as dera e jashtme që ta mbyllje e t'i lije pas kusuret e botës nuk ishte.

Në zërin e Hënës ndihet emocioni i asaj kohe, sakrificat. Bashkë me dr. Agimin kishin hedhur themelet e vatrës së tyre, kishin hyrë brenda, kishin jetuar mes asaj që ishte bërë dhe asaj që ende priste. Dhe tani njëri prej tyre po largohej drejt një vendi tjetër, pa e ditur nëse do të ktheheshin shpejt, pa e ditur sa do të zgjaste ndarja, pa e ditur çfarë forme do të merrte jeta e tyre në një botë tjetër.

- Ndërtimi i shtëpisë ishte sakrificë, - vazhdon Hëna, - por ishte edhe largpamësi. Gimi e kapte situatën shumë shpejt. Ishte shumë i zgjuar. Çdo bisedë që bëhej, ai e ndiqte me sy e me veshë. Nuk humbiste gjë. Dëgjonte, e përpunonte në kokë dhe menjëherë mendonte çfarë mund të bëhej me

atë informacion. Kështu ishte edhe me shtëpinë. Kështu ishte edhe me Kanadanë. Gjithmonë kërkonte një rrugë tjetër.

- Ju kujtohen detaje kur ju iu bashkuat doktorit në Kanada?

- E mbaj mend si sot datën, muaji i parë i pranverës. Kam shkuar më 4 mars. Kur mbërrita në realitetin e ri, gjithçka ishte e mbuluar nga dëbora. Çdo gjë më dukej e ftohtë, e largët, e izoluar. Unë e nisa jetën nga e para. Lekë nuk kishim, Gimi kishte bërë një investim dhe gjendja ishte shumë e vështirë. Kur shkon në një vend tjetër dhe nuk ke para, nuk ke gjuhën, nuk ke njerëzit e tu, edhe gjërat më të vogla të duken të mëdha.

- Çfarë ju rëndonte më shumë në ato ditë të para?

- Gjuha ishte pengesa kryesore. Në Shqipëri unë kisha qenë mësuese frëngjishteje, më pas punova në Akademinë e Shkencave, dija si të komunikoja, dija si të bëja punën time. Atje, nëse nuk di gjuhën, humbet shumë nga vetja. Nuk mund të shprehesh siç do, nuk mund të kërkosh atë që të duhet, nuk mund ta tregosh menjëherë kush je. Prandaj thashë: unë do ta mësoj anglishten, do të bëhem mësuese. Dhe iu futa punës, anglishten e mësova në shtatë muaj e gjysmë. Më ndihmoi që isha mësuese gjuhe. E dija si ndërtohet një gjuhë, çfarë duhet të kapësh, kush janë mekanizmat për ta përvetësuar në kohë.

Në atë botë të largët, ku çdo gjë kishte nisur nga fillimi, po të mos punoje, nuk jetoje dot. Dhe dr. Agimi merr vendim të hapë një restorant, ku të punojnë të gjithë si familje. Por ngritja e këtij biznesi nuk kishte asgjë nga shkëlqimi që mund t'i jepet një historie suksesi kur tregohet shumë vite më vonë.

- E hapëm biznesin, një piceri familjare, duke u sajuar me gjithfarë shkathtësish. Në Kanada njerëzit nxirrnin gjëra jashtë përdorimit. Ne shkonim dhe i merrnim, seleksiononim çfarë mund të përdorej. Bënim rafte, i rregullonim, i përshtatnim. Nuk kishim lekë të shkonim të blinim mobilie e pajisje të reja. E ngritëm me atë që gjenim dhe me punën tonë. Kur e nisëm, aty përreth u mbyllën disa restorante dhe neve na erdhi shumë punë.

- Ku e ndërtuan këtë piceri?

- Zgjedhja lidhej me zgjuarsinë e Gimit. Ai e zgjodhi vendin jashtë qytetit, në një pikë thuajse të vetmuar, por që shumë shpejt do të kthehej

në destinacion turistik. Ai e kishte parë mirë vendin, nuk e hapi rastësisht. Kur filloi puna, na erdhën shumë klientë. Dhe aty nisi një tjetër lloj jete: puno, puno, puno. Por sakrifica më e madhe ka qenë me fëmijët. Këtë nuk e harroj. Endri ishte i vogël. Ne iknim në punë në orën tetë. Ai rrinte vetëm në shtëpi dhe në orën nëntë duhej të nisej vetë për në shkollë. Ishte tetë vjeç. Tetë! Mendoje një fëmijë aq të vogël që e lë vetëm dhe ai duhet të shohë orën, të vishet, të bëhet gati, të mbyllë derën e të shkojë i pashoqëruar në shkollë.

Ajo ndalet një moment dhe pastaj shton me një lloj këmbënguljeje, sikur të dojë ta largojë menjëherë çdo ide se fëmijët e një doktori të njohur janë rritur në rehati.

- Edhe fëmijët e mi nuk janë rritur si çuna doktori. Nuk kanë pasur jetë të lehtë. Edhe ata kanë sakrifikuar me ne. Ne po ndërtonim diçka, por në atë ndërtim hynte edhe fëmijëria e tyre. Kanadaja kishte rregulla të rrepta për lënien e fëmijëve vetëm. Deri në dymbëdhjetë vjeç nuk lejohej. Po të raportonte dikush, vinte policia. Mund të ta merrnin fëmijën. Ne nuk i dinim mirë këto. Sot, kur e mendoj, më duket shumë e rëndë, por atëherë ishim brenda asaj jete. Duhej të shkonim në punë, restoranti duhej hapur, duhej të fitonim, duhej të mbahej familja.

- Ka ndonjë episod që nuk iu hiqet nga kujtesa në ato vite të vështira të fillimit të jetës në Kanada?

- Është një rast që nuk e harroj sa të jem gjallë. Ishte dita e Vitit të Ri. Ne ishim në restorant dhe Gimi tha: "Do të punojmë." Për Vitin e Ri kishte shumë punë, sepse Krishtlindjet njerëzit i festonin më shumë në shtëpi, kurse për Vit të Ri dilnin. Unë po mendoja edhe për fëmijët, ndaj mora gjelin e detit, e poqa, e bëra përshesh. Thashë: do të punojmë, pastaj do të ikim në shtëpi dhe do të hamë të gjithë bashkë. Do ta bëjmë edhe ne Vitin e Ri si familje. Restoranti ishte rreth gjysmë ore larg nga shtëpia. Por erdhën makina njëra pas tjetrës, klientë pa fund dhe ngecëm në punë. Ora kalonte, fëmijët ishin në shtëpi dhe ne ishim aty duke u shërbyer të tjerëve. Kur e mbyllëm restorantin, ishte ora tre e mëngjesit. Në shtëpi, dritat ishin fikur. Çunat i gjetëm në gjumë. Ata na kishin pritur dhe kishin fjetur. Unë hyra, i pashë dhe u ula. Vetëm qaja. Nuk kam futur gjë në gojë, as kam ngrënë,

as kam pirë. Asgjë. Nuk më shkonte. Kisha përgatitur gjelin, kisha bërë përshesh, kisha menduar se do të hanim bashkë dhe pastaj i gjeta fëmijët në gjumë. As të nesërmen nuk doja të fusja gjë në gojë. Më kishte mbetur ajo pamje: fëmijët duke fjetur dhe ne që kishim ardhur në tre të mëngjesit. Imagjino, Vit i Ri. Një natë që duhet të ishim të gjithë bashkë.

Pas një heshtjeje, Hëna vazhdon:

- Gimi ishte jashtë mase i sakrificës. Punonte shumë. Jepte shumë nga vetja. Kur e vendoste një gjë, nuk e kursente veten. Por kemi sakrifikuar të dy, këtë dua ta them. Nuk dua që të duket sikur ai bënte gjithçka dhe unë vetëm e ndiqja. Ne e kemi bërë bashkë atë jetë. Edhe unë kam lënë shumë gjëra, edhe ai ka lënë shumë gjëra. Edhe fëmijët tanë kanë dhënë pjesën e tyre.

* * *

Në këtë pikë të bisedës, afrohet znj. Valentina, motra e Hënës, me një episod që, në dukje, nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me kirurgjinë, por që tregon shumë për mënyrën si mendonte e sillej dr. Agimi.

- Nuk e harroj një rast kur ishim në Kubë. Ishte me ne një inxhinier shqiptar që punonte për AGIP-in në Calgary. Njeri i mirë, që atëherë fitonte jashtëzakonisht shumë, rreth dyqind e tetëdhjetë mijë dollarë në vit, ndërsa paga mesatare ishte rreth dyzet mijë. E kishte kapur qiellin me dorë. Fliste gjithë kohën për veten: sa fitonte, çfarë kishte arritur, çfarë bënte. Gimi rrinte dhe e dëgjonte. E ndoqa një copë herë bisedën, pastaj i fola nën zë Gimit: "E di ky me kë po flet e kë ka përpara?" Gimi më frenoi e më tha me atë mënyrën karakteristike të tij: "Po lëre të flasë. Çdo njeri, kur flet, do të thotë edhe diçka nga e cila mund të përfitosh ti."

Ajo e thotë këtë fjali sikur ta kishte dëgjuar dje.

- Kjo ishte natyra e Gimit. Nuk e pëlqente mburrjen, ai nuk kishte nevojë t'ia tregonte tjetrit kush ishte. Edhe kur tjetri po fliste vetëm për veten, ai mendonte se mund të dilte diçka e vlefshme prej asaj bisede. Përshtatej me çdo situatë, - vazhdon znj. Vali, - dhe merrte të mirën. Nga mendja e Gimit kemi përfituar të gjithë.

Znj. Valentina kujton një prej udhëtimeve të tij në Kanada.

- Një herë kishte ardhur shumë i lodhur dhe më tha: "Thuaji filanit të më çojë tek Universiteti i Torontos, se ai njeh njerëz atje." Kishte një operacion për të bërë dhe donte informacionin më të mirë. Donte të shihte librat. Nuk i mjaftonte ajo që dinte. Thoshte: "Dua ta verifikoj."

Znj. Valentina kujton edhe një tjetër rast. Bashkëshorti i saj kishte një takim me një mjek në Kanada dhe Agimi e shoqëroi. Një vizitë që mund të kishte zgjatur pak minuta u kthye në një bisedë të gjatë profesionale.

- Doktori kishte pacientët jashtë që prisnin. Ata hynë në bisedë dhe harruan kohën. Dy orë qëndruan duke folur për mjekësinë. Pacientët prisnin dhe këta të dy vazhdonin.

Ajo qesh, por menjëherë shton:

- Gimi ishte shumë i dedikuar, shumë i sakrificës dhe jashtëzakonisht i zgjuar.

Hëna, që deri tani e ka dëgjuar motrën, ndërhyn.

- Unë kam thënë gjithmonë se, po të ishte bërë inxhinier ndërtimi, do të kishte qenë shumë i mirë. E kishte pasion edhe atë fushë. Po të ishte bërë artist, futbollist, çfarëdo që të kishte zgjedhur, do të shkëlqente. Sepse, kur futej të bënte një gjë, nuk e bënte përgjysmë.

- Znj. Karaj, kjo karakteristikë e doktorit lidhej vetëm me profesionin e tij?

- Kërcente shumë bukur muzikën popullore, - thotë Hëna. - Shumë bukur. Edhe i ati kërcente. Edhe Elvisi kishte marrë prej tij. Ndërsa djali i vogël, Endri, zero! Ai nuk di fare.

Për disa çaste doktori largohet nga biblioteka, nga librat dhe nga salla e operacionit. Kujtimet, këto grimca drite brenda mendjes sonë, që bartin emocionet e një jete të tërë, në familje, mes miqsh.

* * *

Biseda rikthehet te mjekësia dhe Hëna sjell një nga skenat më të qarta të mënyrës si Agimi përgatitej për një operacion.

- Kam një rast që nuk më hiqet nga mendja. Ishte rreth një vit para se të vdiste. Ai ishte ulur në një kolltuk, përballë televizorit, dhe unë isha në kolltukun tjetër. Mund të ishte ora njëmbëdhjetë e paradites. Nuk po

fliste fare. Rrinte me sytë pothuajse të mbyllur. I thashë: "E mor burrë, sa të del? Gjysma e mijës është pesëqind?" Gimi nuk kishte as humor për t'u përgjigjur. "Ç'e ke qejfin tamam ti... Kam një operacion sot." Mbi tavolinë kishte lënë të hapur një libër mjekësie. Ajo tavolinë mua nuk më pëlqente fare aty, - thotë Hëna. - Më dukej sikur më zinte vend, por ai e kishte bërë këndin e vet. Librat, shënimet, çfarë i duhej, i linte aty. E pyeta: "Po të dhemb ndonjë gjë?" Ai nuk i hapi menjëherë sytë. "Unë tani po imagjinoj operacionin." Tha se po e kalonte të gjithë në kokë. Si një film. Hap pas hapi. Më tha: "Janë si lëvizjet e shahut." Pra po imagjinonte se çfarë do të bënte, çfarë mund të gjente, ku mund të kishte vështirësi. E bënte operacionin më parë në mendjen e vet. Në një moment unë u çova, lëviza nëpër dhomë. Ai qëndroi edhe pak. Pastaj papritur u ngrit dhe shkoi te libri. "Ngeca në një vend", - tha. Hapi librin përsëri, kërkoi atë që donte, e konsultoi dhe vazhdoi përgatitjen. Operacioni doli me shumë sukses.

- Ishte nga ata njerëz që këmbëngulnin edhe kur një gjë ishte e pamundur?

- Jo, Gimi nuk i binte murit me kokë. Kur e shihte që një gjë nuk bëhej, e kuptonte. Këmbëngulte kur shihte se ekzistonte një rrugë. Kjo është tjetër gjë.

Më pëlqen ky saktësim, sepse largpamësia e tij, në kujtesën e dy motrave, nuk lidhet me një kokëfortësi të verbër. Edhe kur mjekët në Kanada, shumë vite më vonë, do t'i thoshin se kishte ardhur koha të mendonte për pjesën që i kishte mbetur nga jeta, ai do ta dëgjonte të vërtetën e tyre. Por Hëna dhe Vali kujtojnë se deri në fund kërkoi të mbetej aktiv, sepse puna, pacientët dhe ideja se mund të ishte ende i dobishëm ishin bërë prej kohësh pjesë e mënyrës si e jetonte kohën.

- Ai e donte shumë jetën, - thotë znj. Vali. - Dhe donte të ishte aktiv deri në fund. Kur dëgjonte se ishte sëmurë ndonjë fëmijë, merrte në telefon mjekët e Pediatrisë. Interesohej, pyeste, ndiqte çfarë po bëhej. Pacientët kishin shumë besim tek ai.

Kur flitet gjatë për një kirurg, ekziston gjithmonë rreziku që pacientët të mbeten në sfond, si raste klinike që vërtetojnë aftësinë e mjekut. Në kujtimet e Hënës dhe Valit ndodh e kundërta. Njerëzit dalin me emra,

familje, vështirësi ekonomike, me dikë që i priste ose me askënd që t'i priste. Hëna kujton Floreshën, një grua nga Pogradeci.

- Floresha ishte e veçantë. Vejushë, me dy djem dhe të dy jashtë shtetit. Nuk ishte në gjendje të mirë ekonomike. Kishte punuar pastruese në shkollë dhe jetonte me pensionin e saj. Gimi e operoi dhe pastaj ajo duhej të vazhdonte trajtimin me rreze në Tiranë. Nuk kishte njeri në qytet, nuk kishte shtëpi ku të rrinte, nuk kishte mundësi për hotel, ishte e vetme. Gimi e pa gjithë këtë dhe e sistemoi në një dhomë këtu, në spital. Kështu, për një periudhë, Amavita u bë edhe vendi ku Floresha flinte. Çdo ditë shoferi e merrte, e çonte në Onkologjik për të bërë rrezet dhe pastaj e sillte përsëri. Këtë Gimi e bënte nga zemra, nuk ishte se dikush ia kërkonte. Ai e pa që gruaja nuk kishte njeri dhe e zgjidhi hallin e saj.

Unë pas daljes në pension, isha në recepsion te Spitali nga mëngjesi në mbrëmje. Është një episod tjetër që më ka lënë përshtypje të thellë. Sapo kishte mbaruar një operacion i vështirë. Ekipi kishte dalë nga salla, unë iu afrova Gimit dhe i thashë "Të kam larë ca qershi dhe ca kumbulla", sepse i kishte shumë qejf. Por pushimi zgjati vetëm pak çaste. Në spital mbërriti një burrë i moshuar, dikur shoqërues i Kadri Hazbiut. Kishte hemorragji dhe gjendja, ishte e rëndë. Ekipi që kishte mbaruar operacionin e mëparshëm po bëhej gati të largohej. Agimi i ndali: "Nuk kemi për të ikur." Dr. Artan Bodeci ishte i lodhur dhe u mërzit. Ishte fundi i një operacioni, energjitë kishin rënë, ndërsa tani duhej të hapej një tjetër sallë, të niste një tjetër përgatitje. Gimi nuk ndryshoi vendim. "Nëse ky nuk futet në operacion, do të vdesë." I moshuari u fut në sallë. Jeton edhe sot.

Unë mbushem me frymë. Qëndrojmë disa momente në heshtje, më tej i them znj. Karaj nëse mund të vazhdojë me episode të tjera të anës profesionale të doktorit.

- Me punën na lidhte ora dhe sekondi çdo ditë, - buzëqesh ajo. Gimi edhe gjumin nuk e kishte të rregullt. Më thoshte: "Mua më punon truri tërë kohës." Kështu ka qenë që në fillim të profesionit... Më kujtohet një grua, Maria... Ajo ishte nënë me tre fëmijë, jetonte pranë Stacionit të Trenit dhe shiste në një barakë të vogël produkte të ndryshme. Një ditë pësoi djegie shumë të rënda dhe përfundoi në shërbimin e Djegie-Plastikës,

pikërisht aty ku Agimi punonte si mjek i ri. Në atë fazë ai nuk kishte ende autoritetin, emrin dhe përvojën që do të fitonte më vonë. I tha shefit: "Ta marr unë përsipër?" Ia besuan si paciente dhe Gimi iu vu me mish e me shpirt ta shëronte. Shkonte tek ajo dy herë në ditë. Më tregonte se plagët duheshin pastruar e trajtuar me shumë kujdes. Ma shpjegonte me një krahasim të vetin: "Është si toka kur heq bimët e këqija." Thoshte se asaj i duhej shërbim dhe kujdes, vazhdimisht. "Nuk i dhemb asaj?", - e pyesja. "I dhemb pak, por unë do t'i shpëtoj jetën."

Dhe Maria shpëtoi. Më vonë, sa herë e shihte doktorin, reagimi i saj e tregonte më qartë se çdo falënderim se çfarë kishte përfaqësuar ai gjatë atyre ditëve. Hidhet përpjetë dhe bërtiste: "O vëlla!" - Hëna buzëqesh kur e kujton: - E kishte si Perëndi! - Pastaj shikon duart e veta dhe kujton duart e tij. - Gimi kishte dorë për kirurgji. I kishte duart të shëndosha, të mëdha, por ishin shumë delikate.

* * *

Pas kaq shumë historish të lidhura me spitalin, dua ta nxjerr pak lexuesin prej tij. Një njeri që kalon pjesën më të madhe të jetës mes pacientëve, operacioneve dhe përgjegjësisë së mjekut duhet të ketë pasur edhe mënyrat e veta për t'u kthyer te jeta e zakonshme, te një drekë, një rrugë, një vend ku mund të ulej pa pasur përpara një kartelë klinike.

- Znj. Karaj, kur puna lihej mënjanë dhe kishit kohë vetëm për veten, çfarë i pëlqente doktorit të bënte?

- Kur u ktheva nga Kanadaja, i kisha humbur edhe mikeshat. Kishte kaluar kohë, secila kishte jetën e saj. Unë kisha ikur, isha kthyer tjetër njeri, edhe marrëdhëniet kishin ndryshuar. Ne dilnim me Gimin. Shkonim shpesh te "Sofra e Ariut" dhe te "Xibraku". Atij i pëlqente shumë gjelbërimi. Gimi nuk e pëlqente luksin. Nuk ka qenë asnjëherë dikush që donte të bënte zhurmë me dukjen e tij. Edhe kur ishte shef pavijoni, edhe kur emrin e tij e kërkonin të gjithë për ndërhyrjet më të vështira, ai nuk hoqi dorë nga thjeshtësia e zakonshme. Ka pasur një fugon të kuq, të lyer edhe me të bardhë, copë-copë. Nuk ishte ndonjë makinë për t'u mburrur. Kur e ndalnin policët dhe u thoshte kush ishte, nuk e besonin që ishte doktor.

- Nuk e kishte problem këtë?

- Fare. Nuk e kishte mendjen te ato gjëra.

- Për çfarë bisedonit në këto dalje jashtë qytetit?

- Gimi e merrte punën me vete në kokë. Mund të ishim ulur diku dhe atij t'i vinte ndër mend një pacient, një gjë që duhej bërë, dikush që duhej telefonuar. Por dinte edhe të kënaqej. E donte jetën. Kënaqej edhe përmes gjërave të vogla. Donte të ishte aktiv. Donte të bënte gjëra. Nuk dinte të rrinte.

- A ju mungon ajo kohë që ndanit bashkë çdo ditë?

- Tani unë ka ditë që nuk di çfarë të bëj me veten. Kur humbet një njeri me të cilin ke ndarë dekada, ndryshon kuptimi i gjithçkaje. Edhe një vend ku ke shkuar dikur, nuk të bën më zemra ta vizitosh si atëherë. Mund të ulesh përsëri në të njëjtin vend, por ai që dikur qëndronte përballë teje ka ikur... dhe nuk do të kthehet më.

* * *

Kur biseda afrohet te fundi i jetës së Agimit, rrëfimi ndryshon ritëm. Tani fjalët dalin më ngadalë, sikur secila prej tyre duhet të kalojë përmes një kohe që ende nuk është larguar plotësisht prej saj.

- Znj. Karaj, ju e kishit njohur Agimin në të gjitha gjendjet e tij, kur ishte i gëzuar, impulsiv, i lodhur, i zemëruar, i mbushur me energji. Çfarë ju ka mbetur më fort nga javët e fundit, kur të dy e dinit se gjërat po ndryshonin?

- Dy javët e fundit më kanë tronditur shumë. Unë e njihja Gimin dhe mendoja se, kur ta kuptonte se fundi po afrohej, do të bërtiste, do të nervozohej, do ta kishte shumë të vështirë. Kisha merak si do ta qetësoja, si do ta zbusja. Përgatitesha sikur më priste një luftë me të. Por ndodhi diçka tjetër, ai bënte humor. Në një nga ditët e fundit, shkova tek ai. Kisha vënë një kapele të kuqe, një pallto lejla dhe kisha rregulluar flokët, por pa ndonjë rëndësi a kujdes të madh. Sapo më pa, tha: "Uau, sa e bukur qenke bërë, moj nuse!" Në dhomë ishte edhe infermier Igli. Vali ndodhej aty gjithashtu. Ai m'i nguli sytë dhe, pothuajse nga asgjëja, nisi të këndonte. Sajoi një këngë për mua. "Moj e bukura ime..." dhe

vazhdonte vetë, me fjalët që i vinin në atë çast... Kjo ndodhi tri apo katër ditë para se të vdiste.

- A ju habiti?

- Shumë. Sepse unë prisja tjetër gjë prej tij. Mendoja se do të ishte i acaruar, se do të reagonte keq. E dija sa shumë e donte jetën.

Dhe pikërisht këtu biseda hyn në një territor më të vështirë.

- Znj. Karaj, a i trembej vdekjes së tij doktori?

Hëna nuk e shmang përgjigjen.

- Gimi ka pasur shumë frikë nga vdekja. Nuk e donte fare atë temë. Unë, për shembull, mund të përmendja Goshin, vëllanë e tij, ose vëllanë tim që kishte vdekur i ri, pesëdhjetë e tre vjeç. Gimi nuk donte të flitej për këto gjëra. Kur përmendja Goshin, bërtiste: "Mos e zër në gojë Goshin!" Për të, sapo përmendje vëllanë që kishte vdekur, kishe sjellë në dhomë vetë vdekjen. Nuk e di pse kishte aq shumë frikë... ndoshta sepse e donte shumë jetën. Rreth tri javë përpara se të vdiste, Elvisi e kishte sjellë lart, në shtëpi. Pasi e ndihmoi të ulej në divan, Elvisi u largua dhe unë mbeta vetëm me të. Gimi më pa në sy dhe tha më zë të ulët "O Hëna, mua më duket se po shkoj te vëllezërit." Nuk e kishte thënë fjalën "vdekje". Nuk e thoshte dot drejtpërdrejt. E përmendte tërthorazi. "Po shkoj te vëllezërit." Ai e dinte çfarë po ndodhte. Kishte qenë në Kanada, kishte bërë vizitat për veten dhe mjekët ia kishin thënë hapur gjendjen.

- Ka zëra që doktori edhe në prag të largimit nga jeta, i priste pacientët dhe bënte konsulta kur e kërkonin ata? - e pyes për ta zbutur pak emocionin personal.

- Deri një javë përpara vazhdonte të punonte, të shihte pacientë. Nuk e jepte veten. Nuk dorëzohej. Edhe kur sëmundja e kishte zhvendosur nga roli i mjekut në atë të pacientit, Agimi kërkonte të ruante një pjesë të ritmit të vjetër. Puna ishte jetë, jeta ishte triumf mbi atë që nuk kishte ardhur akoma të trokiste në derë.

- Znj. Karaj, në ato ditë kur njeriu përballet me kufirin e vet, kërkon ndonjëherë një mbështetje tjetër. Doktori kishte besim fetar?

Hëna mendon pak përpara se të përgjigjet.

- Për pjesën e fesë, kishte një farë besimi. E kishte marrë nga e ëma dhe nga i ati. Babai i tij, atje ku kishte shtëpinë, kishte pranë edhe një objekt kulti. Pra vinte disi nga familja. Herë pas here Gimi mërmërinte ndonjë lutje arabisht, ndonjëherë edhe me humor. Besimi i tij nuk duket se kishte formën e një praktike të rregullt apo të një ligjërimi të madh mbi fenë. Ishte më shumë si një tingull i trashëguar nga prindërit, disa fjalë që i riktheheshin herë pas here në kujtesë. Tingull, por i ardhur nga lart, megjithatë...

* * *

Biografitë janë shpesh të padrejta me njerëzit e zemrës. Bashkëshorteve u lihen disa rreshta, një fotografi, një falënderim i shkurtër, ndërsa pjesa më e madhe e jetës së përbashkët mbetet jashtë përmbajtjes. Hëna Karaj, ka qenë gjysma e universit të dr. Agim Karajt. Ajo e njohu përpara se emri i tij të merrte peshën që do të kishte më vonë, përpara respektit profesional, përpara përgjegjësive që do ta shoqëronin si kirurg. Ajo e njohu si njeriun me të cilin do të ndante kohën, familjen, pasiguritë, ndryshimet e mëdha, periudhat e vështira dhe gjithë ato përvoja që, me kalimin e viteve, bëhen aq të përbashkëta sa nuk di më ku mbaron historia e njërit dhe ku fillon e tjetrit. Dhe ditët e saj, sot, nuk janë thjesht ditë kalendari. Janë ditë me mungesën në zemër, kur s'di ç'të bësh me veten dhe vetmia për dore të mban.

PËRTEJ OQEANIT
- me Endri Karaj -

Tani që mungon Elvisi, rrugica që të çon drejt hyrjes së spitalit Amavita, është po ajo, ndërtesa ka mbetur e njëjta, pacientët vazhdojnë itinerarin e caktuar, megjithatë gjithçka më duket më e errët, më e heshtur, më e vrarë. Hapat më ngadalësohen vetvetiu, sikur trupi ta ketë ndier që po hyja përsëri në një vend ku vetëm pak ditë më parë, Elvisi kishte qenë i pranishëm me gjithë energjinë e tij. Kam ardhur për të takuar Endrin, vëllain e tij, i cili kishte mbërritur nga Kanadaja pas tragjedisë që kishte goditur familjen. Nesër do të marrë rrugën e kthimit përtej oqeanit. Koha për të planifikuar intervistën ishte e shkurtër dhe, në rrethana të tjera, ndoshta do ta kisha shtyrë një bisedë të tillë. Por tani nuk kishte një "herë tjetër" të sigurt. Endri jetonte larg dhe kthimi i tij në Shqipëri kishte ardhur në mënyrën më të dhimbshme të mundshme.

Teksa hyj në Amavita, bluaj përbrenda që brenda pak ditësh, dy vëllezër ishin nisur në dy drejtime krejt të ndryshme. Njëri do të kapërcente sërish oqeanin me biletë në dorë, në orarin e planifikuar, për t'u kthyer te familja e tij. Tjetri kishte ikur pa paralajmërim, pa mundësinë që familja të përgatitej për mungesën e tij. Dy nisje të afërta në kohë, por të pakrahasueshme në gjithçka tjetër.

Endri më pret bashkë me nënën e tij, Hënën. I shoh të dy dhe për disa çaste nuk them asgjë. Hëna ka mbi fytyrë lodhjen e ditëve dhe pikëllimin që ka lënë vraga të thella në fytyrën e saj. Në krah ka Endrin dhe ndoshta është afërsia e gjakut, ndoshta mënyra si qëndron, si lëviz kokën apo si të

vështron, por që në çastet e para kam ndjesinë sikur diçka nga Elvisi ka hyrë përsëri në atë dhomë. Futemi në sallën ku kam zhvilluar edhe intervistat e mëparshme dhe zëmë vend përballë njëri-tjetrit. Gjatë minutave të para e kam të vështirë t'ia heq sytë Endrit. Nuk dua ta krahasoj me të vëllanë, por kujtesa e bën vetë këtë punë. Një vështrim, lëvizja e fytyrës apo ngrohtësia e zërit kur nis të flasë, më rikthejnë Elvisin përpara syve. Por tani kam përballë vetë vëllain e vogël të tij. Është shumë herët që dhimbja të ketë marrë formën e kujtimit të qetë. Gjithçka është ende e freskët, e papërpunuar, e rëndë. E ndez regjistruesin e bisedës dhe bëj pyetjen e parë:

- Elvisi më ka folur për ty me një lloj brerje ndërgjegjeje. Më tregoi se ai kishte qenë fëmija që krijonte më shumë probleme dhe merrte më shumë vëmendjen e babait, ndërsa ti ishe më i qetë. Por dua të nisemi nga ju të dy. Si ishte të rriteshe me Elvisin si vëlla të madh?

Endri ka një lloj hezitimi në zë, dhe e kuptoj që gjithçka brenda kokës së tij është rrëmujë këtë moment. Megjithatë gjen forcën dhe nis të tregojë:

- Kemi pasur gjashtë vjet e gjysmë diferencë në moshë, por kur je i vogël, aq vite janë shumë. Fjala e Elvisit për mua ishte ligj. Ai ishte i madhi i familjes. Pastaj, kur u rritëm, ndryshoi edhe marrëdhënia. Sidomos dhjetë vitet e fundit kishim krijuar një afri shumë të fortë, që ishte bërë instinktive. E merrja në telefon, e pyesja: "A do ndihmë? A mund të të ndihmoj me ndonjë gjë?" Ai ishte gjithë kohës i zënë, mbante disa telefonata njëherësh, kishte punët që s'mbaronin, pacientët, familjen, Amavita-n.

Hëna, që është ulur pranë të birit, ndërhyn dhe më kthen shumë vite pas në kohë:

- Kur Elvisi ishte shtatëmbëdhjetë vjeç, Endri ishte njëmbëdhjetë. Di-ferenca ndihej. Kur shkoja të bëja pazar, i lija vetëm dhe Elvisi ishte përgjegjës për të. E merrte me të mirë. "Lluçi, Lluçi", i thoshte me përkëdhelje.

Endri buzëqesh. Në fytyrën e tij kalon për një çast diçka që nuk arrij ta dalloj nëse vjen prej kujtimit apo prej asaj fjale të vjetër që vetëm njerëzit e shtëpisë dinë ta shqiptojnë me tonin e duhur.

- Nuk kishte sekret mes nesh. Nuk kishte ndonjë gjë që ta mbanim fshehur nga njëri-tjetri.

- Megjithatë më the se keni qenë tipa shumë të ndryshëm.

- Shumë. Unë nuk jam i duhuri për fjalimet e gjata dhe fjalët në përgjithësi. Mua më konsidero si robot, me statistika, me gjërat konkrete. Elvisi ishte tjetër natyrë. Kishte shpirt shumë të gjerë. Ai e kishte instinktive mënyrën si afrohej me njerëzit. I kish ngjarë babit në këtë anë. E kuptonte tjetrin, e dallonte çfarë i pëlqente, çfarë kishte nevojë. Unë këtë e kam parë edhe te djali im. Kur lindi im bir, fillova të vë re tek ai diçka që ma kujtonte Elvisin. Atë ëmbëlsinë që të afrohet vetë, të sheh dhe të kupton pa pasur nevojë t'i shpjegosh shumë. Ia kam thënë edhe Elvisit këtë. Kur e takoi nipin, u lidh aq shumë sa linte kokën për të.

E dëgjoj dhe më rikthehet Elvisi i ulur përballë meje, me atë mënyrën e tij të hapur për të folur, me sytë që ndiqnin çfarë ndodhte rreth tij edhe kur biseda ishte në një drejtim tjetër. Dy vëllezërit kishin qenë të ndryshëm dhe ndoshta pikërisht për këtë plotësoheshin si një e tërë të dy. Hëna ndërhyn, pa i lënë kohë bisedës të marrë frymë e të zhvendoset drejt kujtimeve për dr. Agimin dhe familjen e gjerë. Sikur të kem lënë gjëra të pathëna plotësisht me të, i drejtohem ta pyes:

- Çfarë do të donit të ruanit prej Elvisit fëmijë, znj. Hëna?

Asaj i ndryshon çehrja e fytyrës dhe për pak çaste duket sikur largohet nga dhoma ku jemi ulur.

- Ka qenë fëmijë shumë i bukur, shumë i ëmbël. Dhe që i vogël kishte dëshirë t'i ndihmonte të tjerët.

Pas atyre fjalëve, nis të ndajë një kujtim që e ruante brenda vetes. Në vitet e para të martesës, pas lindjes së Elvisit, Hëna me Dr. Agimin banonin pranë Politeknikumit, ndërsa e ëma e saj jetonte nga ana e Bllokut, pranë shkollës "11 Janari". Hëna e çonte shpesh tek e ëma Elvisin e vogël që t'ia mbante gjatë ditës dhe, për të shkuar atje, duhej të merrte autobusin e Unazës. Ishin udhëtime të zakonshme, të përsëritura aq shpesh sa, pas shumë vitesh, prej gjithë rrugës ka mbetur në kujtesën e saj një zë fëmije, tingulli i Elvisit të saj.

- Në autobus faturinoja thoshte: "Ky autobus është deri te treni, nuk vazhdon më tej." Elvisi rrinte në prehrin tim dhe e dëgjonte. Pastaj, sa herë hipte ndonjë njeri, ai fillonte: "Xhaxhi... te tleni... te tleni..." Po të

ishte grua: “Teta... te tleni...” Njerëzit nuk e kuptonin çfarë thoshte dhe më pyesnin mua. Unë u shpjegoja se po u tregonte që autobusi shkonte vetëm deri te treni.

Hëna buzëqesh ndërsa e tregon dhe për një çast dhoma humbet peshën e ditëve të fundit. Imagjinoj foshnjën në prehrin e së ëmës, i cili ka dëgjuar një fjali dhe mendon se duhet t’ia përsërisë çdo pasagjeri që hipën, që askush të mos ngatërrojë rrugën.

- Mua më duket sikur që atëherë donte t’i ndihmonte njerëzit, - thotë Hëna. - Kjo ishte cilësia më e bukur e tij.

Ai kujtim krijon një lloj liridalje nga formati i ngrirë dhe hijerëndë ku nisi biseda. Kthehem kah Endrit dhe e pyes:

- Ti dhe Elvisi jeni rritur në një familje ku puna nuk lihej pas dore kurrë. Sa e ka përcaktuar kjo mënyrën si je sot ti?

Endri e lidh menjëherë përgjigjen me Kanadanë.

- Në Kanada punonim të gjithë bashkë si familje. Unë kam filluar të punoj në piceri që nëntë vjeç... Shqipëria ishte një realitet i largët tanimë. Më kujtohej që në Tiranë iknin dritat, ikte uji. Merrja karrocën me bidona dhe shkoja të mbushja ujë për mamin. Lëvizja nga “11 Janari” te Blloku, ndërtohej shtëpia, dhe shumë gjëra i bëje sikur të ishe më i madh nga ç’ ishe. Por në Kanada, jeta kishte edhe ajo anën e saj të vështirë.

Pastaj kujton një episod që familja e ka ruajtur aq gjatë, sa dr. Agimi e tregoi edhe shumë vite më vonë në dasmën e Endrit, përpara krushqve kanadezë:

- Isha nëntë vjeç. Babi dhe unë ishim vetëm në piceri. Ishte ditë jave dhe nuk kishte njeri tjetër. Erdhi një porosi për *delivery*. Babi mendoi se do të shkonte shpejt e do të kthehej. Më tha: “Të keqen babi, mos ngacmo gjë se vij shpejt.”

Por dr. Agimi u vonua më shumë seç duhej. Në furrë po piqej një picë dhe, para se ai të kthehej, hyri klienti që e kishte porositur.

- Banaku i picerisë ishte i lartë. Klienti nuk më shihte fare. Unë mora atë lopatën e gjatë të picave dhe u përpoqa ta nxirrja vetë nga furra. Ai shihte vetëm picën që lëvizte me lopatë dhe pastaj fluturoi brenda kutisë. Kur dola unë nga pas banakut, u habit. I thashë: “Kushton gjashtëmbëdhjetë

dollarë.” Kur u kthye babi, gjëja e parë që më pyeti ishte: “Mos u dogj pica?” “Mos ki merak. Ja ku i ke edhe lekët.”, - ia ktheva unë.

Në këtë episod të vogël përmblidhet simbolika e sakrificës së familjes Karaj në Kanada. Dr. Agimi kishte qenë mjek në Shqipëri dhe tani dilte nga piceria për të shpërndarë porosi derë më derë.

- Babi punonte shumë që të mbante familjen, - vazhdon Endri. - Por ndërkohë studionte, krijonte njohje në komunitet dhe u thoshte njerëzve: “Kam qenë doktor dhe dua të bëhem doktor edhe këtu.” Ai nuk e kishte harruar asnjëherë çfarë ishte.

- Kur e kujton babanë në ato vite, çfarë cilësie e tij të del më shpesh përpara?

- Babi ishte *problem solver*. I zgjidhte problemet që dilnin dhe që të tjerët nuk i rregullonin dot. Madje vetëofrohej të bënte edhe gjëra jashtë profilit të tij. Ai nuk kishte frikë nga puna dhe as ne nuk kemi pasur. Kemi punuar me mish e me shpirt, deri në pikën e fundit të gjakut.

- E dije që i fëmijë rëndësinë e profesionit të dr. Agimit?

- Babi më merrte me vete nëpër spitale. Besoj se ideja e tij ishte të më frymëzonte që të bëhesha doktor. Në fakt ndodhi e kundërta, sot i kam inat spitalet.

- Çfarë nuk të pëlqente?

- Në spitale mund të shohësh shumicën e kohës njerëz të sëmurë dhe familjet e tyre të dëshpëruara. I shihja dhe më vrisnin përbrenda. Ka edhe kujtime të bukura, sigurisht. Kur një pacient shërohej, ndodhte që e gjithë familja t’i rrinte babit nga pas nga mirënjohja. Kishte familje nga fshati që i sillnin edhe prodhime nga shtëpia për ta falënderuar.

Njëra prej atyre skenave i ka mbetur e freskët në kujtesë, edhe pas kaq kohësh.

- Mbaj mend se jam kthyer një herë në moshën 14 vjeç nga Kanadaja në Shqipëri. Babi më tha: “Hip në makinë, se do shkojmë te Stacioni i Trenit.” Shkuam, parkuam dhe ai qëndroi brenda. Jashtë ishte një burrë me një thes të zi pranë këmbëve. Babi më urdhëroi: “Shko, merre pak.” Zbrita nga makina dhe e mora thesin. Ishte i rëndë. Duke e parë, dallova një vrimë dhe pashë se brenda kishte një kec të gjallë që merrte frymë me zor. Ia kishin sjellë babait si peshqesh për shërbimin që u kishte bërë.

Këto pamje i përkisnin fëmijërisë së Endrit. Ambientet e punës së doktorit, ishin shpesh vendet ku fëmijët mund të kalonin kohë me babain e tyre.

- Më fuste edhe në vende ku normalisht nuk lejohej të hyja. Ai bënte punën dhe, në të njëjtën kohë, kishte edhe atë mendimin e prindit: "Eja me mua, se kështu kalojmë edhe kohë bashkë."

Hëna kujton se për vite të tëra dr. Agimi kishte shpresuar që njëri prej djemve të vazhdonte mjekësinë.

- Ëndrra e Gimit ishte që të paktën një nga fëmijët të bëhej doktor. Mua më fajësonte. "Ti e ke fajin që fëmijët nuk u bënë mjekë", më thoshte. Unë nuk doja. E njihja mirë atë profesion dhe e dija sa kërkonte prej njeriut. Elvisit i lutej shumë që të bëhej mjek, por as ai nuk donte.

Endri kishte marrë një drejtim tjetër.

- Në Kanada u futëm në biznesin e familjes dhe mendova se duhej të bëja një shkollë që të më ndihmonte ta zhvilloja atë. Kështu zgjodha biznesin. Edhe kjo në gen ishte. Im atë ishte doktor dhe kishte edhe idenë e biznesit. Kjo ishte e rrallë. Kam folur me doktorë në Kanada dhe më kanë thënë vetë: "Sa keq që nuk na japin kurse biznesi." Mjekët zakonisht nuk e kanë atë përvojë. Babi e kishte. Por Elvisi kishte një vizion tjetër. Të dy bashkë ishin kombinim fantastik.

Dr. Agimi kërkonte funksionin, zgjidhjen, punën që duhej kryer. Elvisi kërkonte edhe formën që do të merrte ajo punë.

- Gimi i donte gjërat më të thjeshta. Elvisi i donte të gjetura, e donte të bukurën. Edhe një pjatë në tavolinë Elvisi e donte të sistemuar mirë. Pjata duhej të dukej bukur, mbulesa duhej të ishte e zgjedhur. Babi nuk merrej shumë me këto.

Endri vë buzën në gaz:

- Unë në këtë rast jam si babi. Dua funksionalen. Më pak dekor, më pak rregullime, por të funksionojë. Para se babi të kthehej në Shqipëri, në vitin 1998 u ble ndërtesa e vjetër ku do të ishte piceria. Prindërit dhe Elvisi punuan tek ajo ndërtesë. Më vonë unë e hodha përtokë dhe e rindërtova nga e para.